

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7776 E hënë 28 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga AGRED TAJAJ



Kthesat e papritura të lëvizjes studentore

Në momentin e parë që në fillim am këtë lëvizje, ishte pikërisht instinkti për të arritur atë çfarë në breza na ishte mohuar, respekti për dinjitetin njerëzor ...
Vijon në faqen 20

Opinion i Ditës

Nga ANDI BUSHATI



Letra e 30 shkrimtarëve europianë, si shuplakë për copëtuesit e Kosovës

Letra apel e plot 30 shkrimtarëve europianë (mes të cilëve edhe Ismail Kadare) që bëjnë thirrje për shpëtimin e një Europe që po merr flakë, mund ...
Vijon në faqen 21



Alibeaj: Emërimet, nën kujdesin e Edi Ramës

PD: Emrat e nëntë ish-sigurimsave që drejtojnë Shërbimin Informativ

Prokurori Bujar Sheshi, pjesë e ish-Sigurimit? Nuk është e vërtetë

Partia Demokratike ka akuzuar dje kryeministrin Edi Rama se nëpërmjet emërimit të tij në krye të Shërbimit Informativ Shtetëror, Helidon Bendos, e ka mbushur këtë institucion me ish-sigurimsa të regjimit të shkuar diktatorial. Deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj, në një dalje të posaçme për mediat nga selia blu tha dje se ...
Në faqen 2

TE ZGJEDHURIT E KUVENDIT, ME TE ARDHURA 10 HERE ME TE MEDHA SE PAGA MESATARE

RAPORTI, JA MILIONAT QE MARRIN DEPUTETET

Kush janë më të paguarit, që përfitojnë deri në 5.9 mln lekë nga dietat e karburanti. Deputeti Ilir Xhakolli kryeson për nëntorin dhe dhjetorin



(Në foto) Deputetët gjatë një seance plenare

NGA TAHIRI, TE POLICIA

"The Independent": Shqipëria 'shndërrohet' në Kolumbi të Europës, ja çfarë po ndodh

Në faqen 6

OPERACIONI

Goditet grupi i trafikut të drogës në Greqi, gjashtë në pranga

Në faqen 12

KUJTIMET

Shkrimtari Çela:

Me Dritëroin dhe Kadarenë në kafe "Pjaca"

Në faqen 10-11

SITUATA

SHBA, ultimatum Kosovës: Hiqni taksën me Serbinë, do keni pasojë

Në faqen 18

KESHILLAT E MJEKUT



Ylli Merja: Si të kuroni sinusitin me bimë popullore, simptomat kryesore

Suplement

Mbledhja e këshillit bashkiak në 31 janar/ Vendimet që pritet të miratohen

Ndihma ekonomike, 2924 familjet përfituese

Lista e parë, ja kush do të marrë pagesë nga bashkia

NGA VOLTIZA DURO

Në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës pritet që të miratohet edhe ndihma ekonomike për 2924 familje në kryeqytet. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e plotë të emrave që priten të marrin



3 FAQE SPECIALE

këtë pagesë, pas miratimit në mbledhjen e 31 janarit. Mes këtyre familjeve që do të përfitojnë ndihmën ekonomike, ka dhe persona me statusin e jetimit, viktima të dhunës në familje, individë viktima të trafikimit apo edhe familjet me shumë fëmijë ...
Në faqen 7-9

DENONCIMI OPOZITA

Enkelejd Alibeaj ka akuzuar Ramën se po drejton shtetin me ish-sigurimsa

PD: 9 agjentë të Sigurimit të Shtetit në krye të SHISH, ja emrat

"Operativë të Sigurimit janë emëruar në poste më të larta"

Partia Demokratike ka akuzuar dje kryeministrin Edi Rama se nëpërmjet emërimit të tij në krye të Shërbimit Informativ Shtetëror, Helidon Bendo, e ka mbushur këtë institucion me ish-sigurimsa të regjimit të shkuar diktatorial. Deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj, në një dalje të posaçme për mediat nga selia blu tha dje se me ardhjen e Helidon Bendo në krye të SHISH janë emëruar në krye të këtij institucioni 9 ish-oficerë dhe operativë të Sigurimit të Shtetit në poste shumë të larta drejtuese në kundërshtimin me ligjin, duke treguar edhe emrat e tyre. "Skema për të drejtuar shtetin që pretendon të anëtarësohet në Bashkimin Europian, me njerëz të Sigurimit të Shtetit, tani po funksionon edhe në Shërbimin Informativ Shtetëror: Partia Demokratike disponon të dhëna se nën drejtimin e njeriut të Edi Ramës në shërbimin sekret, Helidon Bendo, të paktën 9 ish-oficerë dhe operativë të Sigurimit të Shtetit janë emëruar në poste shumë të larta drejtuese në kundërshtimin me ligjin e promovimin në detyrë të personave që figurojnë në dokumentacionin e Sigurimit të Shtetit", tha Alibeaj. Ai theksoi se lista jep të qartë emrat dhe detyrat e larta, ku janë emëruar pas marrjes së shërbimit sekret sipas tij, nën kontrollin e Edi Ramës. Alibeaj lexoi emrat e Rafail Milos, Qerim Dedes, Mevlud Matraku, Vladimir Eleziti, Gëzim Bimes, Ilir Tafës, Sokrat Mites, Agim Karrallit dhe Rinald Serhanit. Të gjithë sipas tij ish-punonjës së strukturës famëkeqe të ish-Sigurimit të Shtetit dhe tashmë të emëruar në pozicione drejtuese në SHISH. "Për dy emrat e parë, Autoriteti i Dosjeve ka zbuluar dokumentacion të mjaftueshëm që i bën ata të papërshtatshëm për promovimin në detyrë, ndërsa për 7 të tjerët, ka prova të qarta në dosjet e tyre personale në SHISH se kanë qenë oficerë të shërbimit sekret të diktat-



Deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj

LISTA E ISH-SIGURIMSAVE E PUBLIKUAR NGA PD

- 1 - Rafail Milo:** ish-oficer i Sigurimit të Shtetit. Nga inspektor, ai emërohet drejtor i Departamentit të Administratës në SHISH. Ka në varësi Drejtorinë Juridike dhe atë Ekonomike.
- 2 - Qerim Dedja:** ish-oficer i Sigurimit të Shtetit, nga inspektor emërohet drejtor i Drejtorisë së Sigurisë.
- 3 - Mevlud Matraku:** ish-oficer i Sigurimit të Shtetit, punëtor operativ, kryesisht në Sarandë. Nga inspektor, është emëruar drejtor i Performancës. Bën vlerësimin e të gjitha drejtorive të linjës informative operative.
- 4 - Vladimir Elezi:** ish-punëtor operativ i Sigurimit të Shtetit është emëruar drejtor në SHISH, në Elbasan.
- 5 - Gëzim Bime:** ish-oficer i Sigurimit të Shtetit nga inspektor, emërohet drejtor kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit (drejtori e rëndësishme në punën operative).
- 6 - Ilir Tafë:** ish-oficer i Sigurimit të Shtetit, emërohet drejtor i Drejtorisë SHISH, në Durrës. Vëllai i tij është Afrim Tafë, ish-drejtor policie, i cili është në listat e punonjësve të policisë, i implikuar në trafikun e drogës.
- 7 - Sokrat Mite:** ish-oficer i Sigurimit të Shtetit, nga inspektor, emërohet zëvendës drejtor i Departamentit të Kundërzbulimit.
- 8 - Agim Karrallit:** ish-oficer i Sigurimit të Shtetit, nga inspektor, emërohet drejtor i Drejtorisë SHISH Tiranë.
- 9 - Rinald Serhanit:** ish-oficer i Sigurimit të Shtetit, emërohet drejtor në SHISH.

urës", - theksoi Alibeaj. Ai shtoi se SHISH është vetëm një nga disa sektorët e sigurisë kombëtare, që janë mbushur me eksponentë të ish-Sigurimit të Shtetit, pasi sipas tij, edhe në prokurori dhe në polici janë emëruar elemente të tillë. "Bashkëpunimi me krimin dhe korrupsionin i përparuar në qdo qelizë të qeverisë janë dy tiparet më dalluese të qeverisë së Edi

Ramës. Por skema e sundimit të tij është e paplotë, nëse lihen jashtë saj njerëzit e shërbimit sekret më të egër të Lindjes, Sigurimit të Shtetit. Pasi mori në qeveri të gjithë pasardhësit e Byrosë Politike, miq të afërt të tij, Edi Rama riktheu në poste të rëndësishme drejtues të Sigurimit të Shtetit. Policia e Shtetit sot drejtohet në të gjithë piramidën e saj nga

ish-oficerë dhe bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit. Rasti i prokurorit të Apelit të Krimeve të Rënda, Bujar Sheshi, spiuin i Sigurimit, u emërua në kundërshtim me ligjin, në mënyrë që Edi Rama dhe vegla e tij Arta Marku të kontrollojnë Këshillin e Lartë të Prokurorisë nëpërmjet shantazhit", - u shpreh Alibeaj.

Bujar Sheshi: Nuk kam qenë bashkëpunëtor i Ish-Sigurimit të Shtetit

Anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Bujar Sheshi, ka hedhur poshtë akuzat e ngritura nga opozita se ai ka qenë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit. Në një prononcim për "Top Channel", ai deklaroi dje se nuk është e vërtetë që ka qenë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit. Ai tha se këtë do ta vërtetojë me dokumente. "Nuk është aspak e vërtetë që unë kam qenë pjesë e Sigurimit të Shtetit. Unë do të flas kur të marr të gjitha dokumentet, por kjo nuk është e vërtetë, e vërteta do dalë shumë shpejt", - tha shkurt Bujar Sheshi, i zgjedhur automatikisht në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, pasi nuk kishte kandidat përballë për një vend drejt KLP-së. Sheshi është vënë në qendër të akuzave të opozitës, e cila ka denoncuar se ai ka qenë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit. Ligji shprehet ndalues për kandidatët që pretenduan Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në rast se ata kanë qenë më herët bashkëpunëtorë apo të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit.



LSI: Drejtësia me njerëz pa integritet, të shkarkohet Arta Marku

Opozita kërkon shkarkimin e prokurorës së përgjithshme të përkohshme, Arta Marku. Kërkesa u përsërit sërish dje nga kreu i grupit parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integritim, Petrit Vasili sipas të cilit, Marku shkeli ligjin në rastin e verifikimit të Bujar Sheshit, anëtar i KLP-së. Kreu i grupit të LSI-së akuzon kryeprokurorën se nuk ka përmbytur detyrimin ligjor për të kontrolluar kandidatët që garojnë për në KLP. Sipas tij, zonja Marku i ka bërë kërkesë Autoritetit të Verifikimit të Dosjeve lidhur me kandidaturën e zotit Bujar Sheshi, por pa pritur përgjigjen e tyre, ka përcjellë emrin e tij si kandidat. "Në rastin e një prokurori të caktuar Bujar Sheshit, prokurorja e përgjithshme Arta Marku i është drejtuar me shkresë në datën 26 tetor 2018, ky është dokumenti i cili citohet në vendimin e Autoritetit të Verifikimit të Dosjeve për të kërkuar verifikimin e figurës së këtij prokurori dhe Autoriteti përkatës i verifikimit mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit i kthen përgjigje zj. Arta Marku në përputhje me procedurat e veta në datën 22 janar 2019. Pra, në datën 22 janar. Por ç'ka ndodhur realisht? Arta Marku pa pritur aspak këtë përgjigje, pikërisht në datën 31 tetor, vetëm pesë ditë mbas dërgimit të shkresës tek Autoriteti i Dosjeve e ka përcjellë këtë kandidat, si kandidat pa asnjë lloj problemi dhe si plotësisht të përshtatshëm për të vazhduar kandidimin në KLP dhe praktikisht ky zotëri është anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Sot Arta Marku ka konsumuar haptas dhe qartë një shpërdorim detyre nga më të rëndit, që ka prodhuar pasojë nga më katastrofike, për shkak se ndërtimi i institucioneve të reja të drejtësisë sot është ndërtuar nga njerëz, integriteti i të cilëve nuk është verifikuar", tha Vasili. Sipas tij, ajo për të cilën Reforma në Drejtësi u ngrit, pra për të krijuar filtra të fortë, të pakalueshëm, të pakapërcyeshëm për kandidaturat e diskutueshme, me integritet të ulët etj., sot rezulton me filtra të çara.



Të zgjedhurit në Kuvend arrijnë të ardhura deri në 10 herë më të mëdha se paga mesatare

Zbardhet raporti dymujor, deputetët të ardhura deri në 5.9 mln lekë

Ilir Xhakolli është deputeti më i paguar për nëntorin dhe dhjetorin

Deputetët përbëjnë një nga kategoritë më të paguara në Shqipëri. Ndërsa në vend paga mesatare llogaritet të jetë mbi rreth 45 mijë lekë të reja, të zgjedhurit tanë në Kuvendin e Shqipërisë arrijnë të sigurojnë të ardhura mesatarisht 6 herë më të mëdha. Kështu, ndonëse paga bruto shkon në vetëm 155 mijë lekë në muaj, ata arrijnë të sigurojnë të ardhura edhe një herë më shumë nga pagesa për karburantin, dietat, telefonin dhe një sërë benefitesh të tjera që u jep statusi i deputetit. Kuvendi ka publikuar të ardhurat e deputetëve për muajt nëntor dhe dhjetor dhe ku rezultojnë se në total një deputet për dy muaj ka arritur të marrë deri në 560 mijë lekë të reja. Pra, një shumë rreth 10 herë më e madhe sesa është paga mesatare në vend. Deputetët që kanë siguruar të ardhurat më të mëdha janë ata që janë dhe më të rregullit në pjesëmarrjen në komisionet dhe seanca plenare, ndërsa marrin edhe pagesa për qira dhe qëndrime në hotele.



OPOZITA

Pavarësisht se bojkotuan aktivitetet parlamentare, deputetët e opozitës kanë arritur të marrin të ardhura që shkojnë mesatarisht në 300 mijë lekë në dy muaj apo rreth 1.5 milionë lekë në muaj. Deputetët opozitarë që kanë arritur të sigurojnë më shumë të ardhura në këto dy muaj janë Gent Pollo dhe Luçiano Boçi.

MË TË PAGUARIT

Listën e deputetëve me më shumë të ardhura e kryesojnë deputetët socialistë, të cilët kanë qenë dhe më korrekta në pjesëmarrjen e tyre në jetën parlamentare. Listën e kryeson pikërisht deputeti i qarkut të Korçës, Ilir Xhakolli, i cili ka arritur të marrë në dy muaj plotë 600 mijë lekë të reja neto, ose nga 300 mijë lekë çdo muaj. Kjo është shuma që Xhakolli ka futur në xhep, pasi më parë i janë hequr taksat dhe sigurimet shoqërore. Në këtë shumë të ardhurat kryesore janë nga karburanti, dietat, qiraja, telefoni, pasi paga neto në dy muaj arrin në vetëm 230 mijë lekë të reja në muaj. Pas tij, deputeti që ka siguruar më shumë të ardhura është deputeti i qarkut të Vlorës, Edmond Leka. Ai ka marrë afro 570 mijë lekë të reja dhe ashtu si Xhakolli, edhe ai ka siguruar më shumë të ardhura nga dietat, telefonin dhe karburantin. I treti në listën e deputetëve më të paguar është deputeti i qarkut të Fierit, Anduel Xhindi, me plot 545 mijë lekë të reja neto dhe lista vazhdon me disa deputetë tjerë si Erion Braçe, Ilir Pendavijnji, Rob-

TË ARDHURAT E DEPUTETËVE PËR MUAJT NËNTOR DHE DHJETOR 2018

1	Agron Cella	392206	lekë	66	Edlira Bode	498814	lekë
2	Adelina Rista	487356	lekë	67	Edmond Haxhinasto	310294	lekë
3	Albana Vokshi	389180	lekë	68	Elisa Siprojari	413731	lekë
4	Aldo Bumçi	369897	lekë	69	Elona Hoxha	383573	lekë
5	Anastas Angjeli	423135	lekë	70	Endri Hasa	304311	lekë
6	Andrea Maro	487356	lekë	71	Endrit Brahmlilari	270283	lekë
7	Antoneta Dhuma	483556	lekë	72	Enklejda Alibaj	240833	lekë
8	Anduel Xhindi	534906	lekë	73	Ervin Salianj	290833	lekë
9	Bashkim Fino	433731	lekë	74	Fadil Nasufi	549356	lekë
10	Besnik Baraj	423763	lekë	75	Fatbardha Kadriu	337921	lekë
11	Blerina Gjylameti	408763	lekë	76	Fatmir Velaj	452106	lekë
12	Bujar Celi	463556	lekë	77	Fiamur Golemi	437085	lekë
13	Dashamir Shehi	323951	lekë	78	Florida Kërpaçi	323573	lekë
14	Edi Paloka	305458	lekë	79	Gjetan Gjetani	300929	lekë
15	Edmond Spaho	344044	lekë	80	Grita Shqina	232757	lekë
16	Erion Braçe	514138	lekë	81	Hailim Kosova	248323	lekë
17	Ervin Bushati	427763	lekë	82	Hekuran Hoxhalli	306294	lekë
18	Evis Kushi	484760	lekë	83	Ilir Beqaj	364822	lekë
19	Fatmir Mediu	307108	lekë	84	Ilir Ndraxhi	423731	lekë
20	Fidel Ylli	397517	lekë	85	Ismet Beqiraj	437731	lekë
21	Flamur Noka	301821	lekë	86	Isuf ?elaj	290337	lekë
22	Florion Mima	301821	lekë	87	Imzira Ulqinaku	451544	lekë
23	Genc Pollo	2212	lekë	88	Jurgis ?vrbja	447784	lekë
24	Gent Strazimir	327073	lekë	89	Klervis Balliu	343541	lekë
25	Gramoz Ruci	452570	lekë	90	Klotilda Bushka	384138	lekë
26	Ilir Xhakolli	583956	lekë	91	Lindita Metalaj	406888	lekë
27	Ilirjan Pendavijnji	521356	lekë	92	Lorenç Luka	381554	lekë
28	Jorida Tabaku	307610	lekë	93	Luan Harusha	318356	lekë
29	Klodiana Spahiu	483556	lekë	94	Luan Baçi	392186	lekë
30	Kejdi Mehmetaj	328894	lekë	95	Lulezim Basha	285370	lekë
31	Luan Rama	297311	lekë	96	Myslim Murriçi	290337	lekë
32	Duza Duzha	436760	lekë	97	Nadire Mëcorapaj	349689	lekë
33	Luçiano Boçi	400874	lekë	98	Naco Naco	278388	lekë
34	Monika Kryemadhi	368187	lekë	99	Nora Maslova	326944	lekë
35	Musa Ulliri	421155	lekë	100	Norja Belba	430760	lekë
36	Nard Ndoka	429504	lekë	101	Orjola Pampuri	323573	lekë
37	Oerd Bylykbashi	336046	lekë	102	Reme Xhelilaj	423731	lekë
38	Pavlos Sterkaj	403731	lekë	103	Roland Xhelilaj	476454	lekë
39	Perparim Spahiu	306294	lekë	104	Romeo Gurakuqi	392096	lekë
40	Plerin Ndreu	516676	lekë	105	Rrahman Hajdari	421764	lekë
41	Saki Suli	434957	lekë	106	Rudina Nurçe	318356	lekë
42	Robert Bitri	536608	lekë	107	Sadi Vorpsi	411763	lekë
43	Sadri Abazi	332138	lekë	108	Sezai Brokaj	318356	lekë
44	Sali Berisha	323195	lekë	109	Tatiana Nurçe	461356	lekë
45	Taulant Balla	421840	lekë	110	Tritan Shehu	392487	lekë
46	Doshi Doshi	345578	lekë	111	Valentina Duka	318356	lekë
47	Ulsi Manja	432187	lekë	112	Viktor Tushaj	440827	lekë
48	Vangjel Dule	456038	lekë	113	Vilma Bello	503083	lekë
49	Vangel Tavro	469680	lekë	114	Vullnet Sinaj	449731	lekë
50	Vasilika Hysi	341668	lekë	115	Xhemal Gjunkshi	308331	lekë
51	Xhemal Qefalia	419763	lekë	116	Xhelantina Gjermeni	420700	lekë
52	Edmond Leka	569356	lekë	117	Klajda Cjoshaj	238994	lekë
53	Dhurata Cupi	265726	lekë	118	Milva Ikonomi	414159	lekë
54	Xhevit Bushaj	547356	lekë	119	Mimi Kodheli	387630	lekë
55	Petrit Vasili	410150	lekë	120	Eduart Shlisi	527935	lekë
56	Adnor Shameti	419354	lekë	121	Emonela Felaj	441134	lekë
57	Agron Shehaj	231044	lekë	122	Leter Koka	363972	lekë
58	Alket Hyseni	435931	lekë	123	Edmond Panariti	343541	lekë
59	Almira Xhembullia	483556	lekë	124	Dritan Bici	431490	lekë
60	Andon Frrakaj	273060	lekë	125	Silva Caka	278388	lekë
61	Arben Pellumbaj	432249	lekë	126	Astrit Velajaj	258743	lekë
62	Arben Kamami	439210	lekë	127	Spartak Braho	443784	lekë
63	Arben Spahiu	335902	lekë	128	Fatmir Xhafa	318523	lekë
64	Bledar Zuci	424181	lekë				
65	Elena Xhina	450760	lekë				

Kryetari dhe nënkryetarët, karburant dhe pagesë telefoni pa limit

Ndonëse në llogarinë e tij bankare kanë kaluar vetëm 452570 lekë për muajt nëntor dhe dhjetor, kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruci rezultojnë të jetë de facto edhe deputeti më i paguar i Kuvendit të Shqipërisë. Kjo për vetë faktin se tek të ardhurat e tij nuk janë llogaritur pagesa për karburantin dhe telefonin. Sipas ligjit dhe Rregullores së Kuvendit, kryeparlamentari, ashtu si edhe kryeministri apo ministrat e kanë karburantin pa limit, pasi lëviz me makina të shtetit dhe i shoqëruar nga Garda e Republikës, që kujdeset për sigurinë e tij. Kujtojmë se Ruci merr një pagë mujore prej 228 mijë lekë të reja mujore bruto, ose afërsisht 165 mijë lekë të reja neto në muaj. Po kështu, pa limit kryetari i Kuvendit ka edhe telefonin celular, ndryshe nga deputetët që kjo shumë shkon mesatarisht në 17 mijë lekë të reja në muaj. Në të njëjtat kushte janë edhe nënkryetarët e Kuvendit, të cilëve në tabelën e të ardhurave nuk i përfshihen pagesa për telefonin dhe karburantin. Nënkryetarët kanë një pagë bruto afërsisht 183 mijë lekë bruto në muaj ose 138 mijë lekë të reja neto.

ert Botri etj., të cilët kanë siguruar mbi 500 mijë lekë të ardhura.

OPOZITA

Ndonëse morën pjesë vetëm në dy seancat e fundit të dhjetorit, deputetët e opozitës kanë arritur që edhe pa qenë prezentë në shumicën e jetës parlamentare të sigurojnë të ardhura të konsiderueshme për nëntorin dhe dhjetorin. Kjo

për faktin se mosprania në Kuvend nuk ndalon pagesën për telefonin, karburantin apo qiratë e ndryshme. Ndaj pavarësisht se bojkotuan aktivitetet parlamentare, deputetët e opozitës kanë arritur të marrin të ardhura, që shkojnë mesatarisht në 300 mijë lekë në dy muaj apo rreth 1.5 milionë lekë në muaj. Deputetët opozitarë

që kanë arritur të sigurojnë më shumë të ardhura në këto dy muaj janë Gent Pollo dhe Luçiano Boçi, të cilët kanë futur në "xhep" mbi 400 mijë lekë secili. Ndërkohë që ndër deputetët me më pak të ardhura në këto dy muaj sipas raportit të Kuvendit renditen kryetari i PD-së Lulzim Basha, deputeti Agron Shehaj si dhe deputeti Andon Frrakaj.

ZGJEDHJET VENDORE ORGANIZIMI

Krahas protestave, PD ka ndezur 'motorët' edhe për zgjedhjet lokale

Zgjedhjet lokale, Basha udhëzim për ngritjen e shtabeve elektorale

Spaho: Do të duhet një qeveri transitore e përgjegjshme

Ndonëse deri më tani nuk e ka bërë të qartë nëse do bëhet pjesë e zgjedhjeve të ardhshme vendore që do të mbahen në datë 30 qershor, Partia Demokratike ashtu si edhe Lëvizja Socialiste për Integrim kanë vendosur që të punojnë paralelisht edhe me përgatitjet elektorale, ashtu si edhe me të bërin opozitë. Kështu, krahas organizimit të protestave, Partia Demokratike ka ndezur 'motorët' edhe për zgjedhjet lokale. Në një udhëzim të shpërndarë për deputetët dhe anëtarët e kryesisë nga kryetari Lulzim Basha dhe sekretari i përgjithshëm, Gazmend Bardhi kërkohet fillimi i punës për ngritjen e shtabeve elektorale në çdo degë lokale.

UDHËZIMI

Udhëzimi thotë që duhet të nisë puna për identifikimin e personave që do të jenë në shtabet elektorale, në zbatim të vendimit të kryesisë. Në të njëjtën linjë me këtë udhëzim është dhe vendimi i kryesisë për identifikimin dhe thirrjen e të gjithë atyre personave që kanë kontribuar për Partinë Demokratike nga viti 1991, qofshin ata ish-deputetë apo ish-kryetarë bashkish. Po ashtu, kërkohet që të merren masa për takime të kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Basha, në rrethe si përgjegjësi kryesor për të organizuar të gjitha strukturat e partisë. Ndërkohë që Këshilli i Kombëtar i Partisë Demokratike u delegoi organeve të reja drejtuese, kryesisë dhe sekretariatit organizativ edhe organizimin e protestave. Dhe duket se strategjia e opozitës është që nëpërmjet protestave të detyrojë mazhorancën që të pranojë krijimin e një qeverie tranzitore, e cila do mundësojë zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Në zbatim të vendimit të Këshillit Kombëtar, kryesia caktoi datën dhe strategjinë e protestave.

SPAHO

Krijimin e një qeverie tranzitore e mbështeti dje



Lulzim Basha me kryesinë e PD-së

PD: Rama firmosi që në Parkun e Zagorisë të shpohet për naftë

Partia Demokratike ka akuzuar dje kryeministrin Edi Rama se ka hedhur firmën për zbatimin e projektit për kërkimet për naftë në Parkun Kombëtar të Zagorisë. Anëtar i Kryesisë në PD, Jamarbër Maltezi, përmes një deklarate për mediat publikoi disa dokumente që sipas tij vërtetojnë se Rama firmosi që në Parkun Kombëtar të Zagorisë, pjesë e bllokut 4, të shpohet dhe të kërkohet për naftë. Maltezi u shpreh se protesta dhe qëndresa është e vetmja gjuhë që njih frikacakun Edi Rama. "Protesta e Zagorisë nxori përpara shqiptarëve një kryeministër frikacak dhe mashtrues të pacipë, për të mbu-



luar aferat e tij në grabitjen e pasurive të vendit. 'Nuk bën vaki që qeveria të lejojë shpime naftëkërkuese në një park kombëtar' - ishte deklarata e Edi Ramës për të frenuar protestat e banorëve. Në të vërtetë, ky është një mashtrim flagrant i një kryeministri frikacak. Vakia ka ndodhur dhe ka

ndodhur me praninë dhe firmën e vetë Edi Ramës. Në 20 shkurt 2018, të gjitha mediat raportuan për arrijten e një marrëveshjeje historike, që do të na bënte si Arabia Saudite me shpinë në bllokun 4, zona me Gjirokastrës dhe Sarandës. 4 muaj më vonë, më 12 qershor, marrëveshja u miratua në Këshillin e Ministrave dhe mban firmën e Edi Ramës. Ai mund të dalë dhe të thotë se këto fakte janë fotomontazh! Çfarë nuk bën vaki me këtë kryeministër! Por e vërteta është se Edi Rama i ka gënjyer shqiptarët sy për sy. Ai ka firmosur që në Parkun Kombëtar të Zagorisë, pjesë e bllokut 4, të shpohet dhe të kërkohet për naftë!", - tha Maltezi.

edhe nënkryetari demokrat i Kuvendit, Edmond Spaho, i cili tha për "Ora News" se me rëndësi është largimi i kryeministrit Edi Rama, pasi vetëm kështu do të shkëputeshin lidhjet e tij me bandat e vjedhjes së votave. Spaho tha se qeveria tranzitore mund të dalë edhe nga PS, por të përbëhet me njerëz me integritet. "Do të duhet një

qeveri transitore e përgjegjshme, qoftë edhe e dalë nga Partia Socialiste, por me njerëz të cilët kanë integritet dhe janë të përkushtuar apo të përgjegjshëm ndaj zhvillimeve në vend", - tha Spaho. Sipas tij, është kryeministri Edi Rama, ai që ruan lidhjet e qeverisë me krimin dhe ka krijuar partneritet me bandat. "Ka një dosje në

prokurori, ku evidenton kryetarin e Bashkisë së Durrësit duke folur me kontingjentët të rëndësishëm të grupeve kriminale, njerëz të cilët kanë pasur në posedim laborator kokaine. Po kështu, ka fakte për ministrat", - tha Spaho duke theksuar rëndësinë e një qeverie transicioni, e cila do t'i jepte fund fenomenit të vjedhjes dhe blerjes së votës.

QEVERIA

"Do të duhet një qeveri transitore e përgjegjshme, qoftë edhe e dalë nga Partia Socialiste, por me njerëz të cilët kanë integritet dhe janë të përkushtuar apo të përgjegjshëm ndaj zhvillimeve në vend", - tha Spaho.



LSI: Studentët në protestë, Rama hap ekspozitë me piktura në Gjermani

Lëvizja Socialiste për Integrim ka denoncuar dje se ndërsa studentët nuk kanë kushte për të studiuar dhe lekë për të blerë libra, kryeministri Edi Rama hap ekspozitë të shtrenjta. Duke iu referuar pikërisht ekspozitës që kreu i qeverisë ka hapur në Gjermani, deputetja e LSI-së, Floida Kërpaçi ka deklaruar se ky është një tjetër shembull që tregon se kryeministrit nuk i bëhet vonë fare për studentët. "E ndërkohë që studentët nuk kanë mundësi të paguajnë tarifën e larta, kryeministri hap ekspozitë me pikturat e tij. Studentët nuk kanë libra, nuk kanë konvikte, studentët duhet të kenë tualete, kryeministri shkon hap ekspozitë me pikturat e tij. Studentët nuk kanë bibliotekë, nuk kanë kartë studentit, por merakun më i madh i kryeministrit është të shkojë të hapë ekspozitë. Boll i vodhët paratë e shqiptarëve me koncesione, me fasada e me ekspozita personale. Studentët nuk kanë nevojë për mashtrime, kanë nevojë për mbështetje reale, jo imagjinare me video 3D. Amendamentet e LSI rrisin buxhetin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor", - tha Kërpaçi. Ajo bëri të ditur se problemet e studentëve i zgjidhin pikërisht amendamentet që LSI ka paraqitur në Kuvend dhe që nisnin të diskutohen sot në komisionet parlamentare. "Amendamentet janë një vijë ndarëse ndërmjet atyre që janë kundër dhe atyre që realisht mbështesin studentët. Amendamentet janë vija ndarëse ndërmjet mashtrimit dhe të vërtetës. Tashmë, Edi Ramës i është çjerrë maska përpara të gjithëve! E vetmja rrugë është protesta e revolta e të rinjve, qytetarëve shqiptarë, deri në largimin e Edi Ramës, e për të hapur rrugën e zhvillimit të vendit dhe për ta bërë Shqipërinë, shtëpinë e shqiptarëve", - tha Kërpaçi.

Njoftim për shitje me ankand te trete

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k. bazuar në nenet 577, 568 të K.Pr.Civile ka shpallur në datë 21.01.2019 - shpalljen me ankand të lirë të pasurisë palës debitorë, hipotekuese dhe palës dorëzuesë.
 ■ "Tokë Are" në Z.K 1987 me numër pasurie 30/38 Volumi 19 Faqe 71, me sipërfaqe 1000 m2 Lezhe me cmim fillësar prej 52.214.4 Euro
 ■ "Tokë Are" në Z.K 1987 me numër pasurie 40/56 Volumi 11 Faqe 92, me sipërfaqe 1730 m2 Lezhe me cmim fillësar prej 88.301.8 Euro
 ■ "Tokë Are" në Z.K 1987 me numër pasurie 25/73 Volumi 15 Faqe 239, me sipërfaqe 2.000 m2 Lezhe me cmim fillësar prej 88.301.8 Euro
 Ankandë qendrën i hapur për 30 ditë dhe do të zhvillohet në datën 20.02.2019 në orën 15:00, në sallën tërë Bulev "Çi. Fierbe" Kulla 1, Kat 2, Zyra nr. 5 kontakto 0672082453 ose email dir_dorje@powerandjustice.com dhe në WEB www.powerandjustice.com.



Ministria e Jashtme nuk ka dërguar për botim në Fletoren Zyrtare urdhrin e Ramës

Cakaj "ministër", delegimi s'është publikuar në Fletoren Zyrtare

Sipas ligjit, delegimi i kompetencave duhet publikuar

Fjala më e shkurtër e jetës sime, unë i nënshtrova kryetari Edi Rama, në funksionin e kryeministrit dhe të ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme, i delegoj zotit Gent Cakaj, zv.ministër për Europën e Punët e Jashtme, detyrën si ministër për Europën e Punët e Jashtme dhe përfaqësimit të ministrit për Europën dhe Punët e Jashtme brenda dhe jashtë shtetit". Kështu do të deklaronte kryeministri Edi Rama në ceremoninë e dorëzimit të detyrës së ministrit të Jashtëm më 23 janar. Kanë kaluar disa ditë, por vendimi i kryeministrit nuk është botuar në Fletoren Zyrtare. Sipas ligjit, vendimi për delegimin e kompetencave duhet të botohet në Fletoren Zyrtare, duke përcaktuar edhe afatet e ushtrimit të kësaj detyre, për të marrë kështu edhe fuqi ligjore. Kjo nënkupton se kryeministri duhet të përcaktojë edhe datën si afat final të ushtrimit të detyrës nga ana e ministrit Cakaj si ministër i Jashtëm në arenën ndërkombëtare. Kodi i Procedurës Administrative parashikon delegimin e kompetencave. Një praktikë e tillë bëhet pothuajse nga të gjithë drejtuesit e institucioneve, ministra apo zyrtarë të tjerë, të cilët për një periudhë kohe ua kalojnë kompetencat vartësve të tyre. Ky vendim duhet të përmbajë si rregull edhe afatet e ushtrimit të detyrës që i delegohet. Neni 28 i këtij Kodi përcakton se "Përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe, organi që delegon një kompetencë nuk mund të autorizojë organin e deleguar apo të nëndeleguar, që ky i fundit t'ia nëndelegojë këtë kompetencë një organi tjetër.



KODI

Neni 28 i këtij Kodi përcakton se "Përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe, organi që delegon një kompetencë nuk mund të autorizojë organin e deleguar apo të nëndeleguar, që ky i fundit t'ia nëndelegojë këtë kompetencë një organi tjetër.

Shqipëria "Shtëpi e Jetës", Meta: S'duhen lejuar veprime çnjerëzore

Shqipëria u shpall "shtëpi e jetës" nga fondacioni Ndërkombëtar Raoul Wallenberg, për kontributin që ka dhënë në shpëtimin e hebrenjve gjatë luftës së dytë botërore. Për të përkujtuar viktimat e holokaustit, në lulishten pranë Presidencës u ngrit pllakata, e cila u përrua nga Presidenti Ilir Meta. Në fjalën përshëndetëse, Meta theksoi se kjo ngjarje nderon dhe respekton të gjithë shqiptarët. "Në mënyrë të veçantë ky akt nderon ata burra dhe gra shqiptare, që të udhëhequr nga kodi ynë shumëshekullor zakonor i mikpritjes dhe Besës, nën parimin se 'Shtëpia e shqiptarit është e Zotit dhe e mikut', strehuan bujarisht e pa u kursyer, vunë në rrezik jetën e tyre dhe atë të familjeve, duke shpëtuar nga përndjekja dhe shfarosja e sigurt, qindra e mijëra hebrenj gjatë Holokaustit, njëres prej periudhave më të errëta të njerëzimit", - tha presidenti Meta. Ai shtoi se apeli i viktimitave të holokaustit është kurrë më gjenocide të tilla njerëzore ndaj kujtdo që i përket një feje, etnie apo kombësie të ndryshme. "Gjenocide dhe veprime të tilla çnjerëzore ndaj kujtdo që i përket një feje, etnie apo kombësie të ndryshme, nuk mund të ndodhin dhe mbi të gjitha, nuk duhen lejuar të ndodhin kurse si në botën ku jetojmë të gjithë sot! Kurrë më! Ky është apeli i të mbijetuarve të Holokaustit, disa prej të cilëve shpëtuar në këtë truall, pikërisht falë shpirtit altruist të shqiptarëve dhe ky është edhe mesazhi ynë sot, nga Tirana, kryeqendra e 'Shtëpisë më të re botërore të Jetës!', - u shpreh Presidenti Meta. Ndërsa zëvendës-presidenti i Fondacionit Ndërkombëtar "Raoul Wallenberg", Daniel Rainer në fjalën e tij vuri në dukje se në Shqipëri nuk është dëgjuar të ketë pasur as edhe një rast të vetëm denoncimi. Sipas tij, heroizmi i popullit shqiptar duhet t'i bëhet me dije gjithë botës.



SHPLLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E.G. Bailiff Service" me përmbaues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruvoja, Pall 64, Hyrja B, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 16.02.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i l-rë për shiten e pasurisë së paluajtshme. Apartament me sipërfaqe totale 86.35 m², me numër pasurie 2/139/ND+1-13, volumni 71, faqe 142, zona kadastrale 8519, me adresë Lagja 13, Plazh, Hyrja 1, Ap.13 Durrës, në pronësi të Z. Qirim Sejfulla Xhafa dhe Znj. Bardha Xhena Xhafa me vlerë fillëtare në ankan 32,468 (Tërçjet e dy mijë e katërcind e gjashtëdhjet e tetë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888, email enuar.merko@gmail.com

ike për të vepruar ose për shkak të ndonjë pengese ligjore që haset në organ administrativ individual, kryerja e detyrave bëhet nga organi ose personi zëvendësues i përcaktuar me ligj". Në pikën dy të po këtij neni theksohet se kur ligji nuk shprehet, zëvendësimi në kryerjen e detyrave do të bëhet nga punonjësi më i vjetër i organit, që vjen direkt pas tij në shkallën e hierarkisë. Në ushtrimin e funksioneve të zëvendësuesit futen edhe kompetencat e deleguara të të zëvendësuar. Kryeministri Edi Rama i pro-

pozoi Presidentit Ilir Meta, emrin e Gent Cakajit si ministër i Jashtëm. Ky propozim hasi në kundërshtimin nga kreu i shtetit, i cili refuzoi të dekretonte Cakajin si ministër të Jashtëm. Kjo krizë institucionale u zgjidh me tërheqjen e kryeministrit, duke mos paraqitur më zyrtarisht Cakajin si ministër, por veten e tij para presidentit. Ndërkaq, pas zgjidhjes së kësaj krize, mazhoranca shprehet se këtë përplasje institucionale do t'ia paraqesë Gjykatës Kushtetuese për interpretim, nëse presidenti ka të drejtë për të refuzuar propozimet për

ministra ose jo. Derisa kjo çështje të zgjidhet, kryeministri ka vendosur që të mbajë Cakajin si kryediplomat me delegim kompetencash. Por gjithashtu mazhoranca ka bërë të ditur se pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ku ata pretendojnë se do të jetë në favor të tyre, Gent Cakaj do të propozohet sërish si ministër i Jashtëm te presidenti. Pak ditë më parë, MEPJ u dërgoi një letër ambasadave ku i bënte të ditur se Cakaj kishte kompetencat e ministrit të Jashtëm.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Sigurimi i jetës, kujdesit shëndetësor dhe siguracioni i shëndetit në udhëtim për punonjësit e Bankës së Shqipërisë, për një periudhë tre vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 71,082,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Sigurimi i jetës, kujdesit shëndetësor dhe siguracioni i shëndetit në udhëtim për punonjësit e Bankës së Shqipërisë, për një periudhë tre vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 18 Shkurt 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

ndërsa neni 29 parashikon se "Në rastet e delegimit, organi delegues përcakton kompetencat të cilat janë deleguar ose tregojnë se çfarë atkesh mund të nxjerrin apo të zbatojnë organet e deleguara. Delegimi i kompetencave botohet në Fletoren Zyrtare. Ndërsa në rastet e administratës vendore delegimi botohet në gazetën e pushtetit vendor dhe kur nuk ekziston një e tillë, njoftimi përkatës afishohet në vende publike". Ndërkaq, po në këtë ligj, në nenin 34 parashikohet se "në rastet e mungesave, të pamundësisë apo të paafësisë fiz-

Autoritetet shqiptare s'kapin më shumë se 5% të drogës që kalon nga ata

"The Independent": Shqipëria "shndërrohet" në Kolumbi

Gazetari: Çudi që Rama s'i hoqi imunitetin Tahirit

Një investigim mbi trafikun e drogës, prestigjiozja angleze "The Independent" e konsideron Shqipërinë si Kolumbinë e Evropës. Në kohën kur zyrtarët shqiptarë raportojnë se kapen 10 për qind të sasisë që trafikohet, nga ana tjetër një diplomat perëndimor thekson se Shqipëria është kthyer tashmë në një narko-shtet. Mes tjerash, ai i referohet shifrave duke shtuar se autoritetet shqiptare nuk arrijnë të kapin më shumë se 5 për qind të sasisë së drogës që kalon nga Shqipëria në drejtim të vendeve të tjera. "Kjo u lë trafikantëve kaq pasuri sa për të blerë autoritetet e porteve nga Roterdami në Izmir", tha ai. Në shkrimin e publikuar nga media britanike thuhet mes tjerash se Shqipëria është kthyer si seli qendrore e trafikut të drogës në kontinentin e Europës. Ky lloj trafikimi mendohet se ka lidhje e përkrahje edhe nga radhët e politikës, ndërsa lufta për çrrënjosjen e saj duket si një aventurë jo shumë e lehtë, pavarësisht kushteve dhe ofertave për anëtarësim të Shqipërisë drejt BE-së. "Është Kolumbia" e Europës. Është prodhues dhe shpërndarës i drogës në Europë. Është një narko-shtet. Ata do humbasin shumë para nëse heqin dorë nga trafiku për të hyrë në BE", - theksoi një diplomat. Gazetari përmend edhe



ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahirin, ku sipas tij, emri iu publikua nga telefonatat dhe përgjimet me trafikantët. Mes tjerash, gazetari i medias britanike tregon me habi se si kryeministri Edi

Rama qëndroi pranë tij, duke moslejuar heqjen e imunitetit dhe arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm. Pasqyrim të detajuar ka gjetur edhe Klement Balili, i cili u vetëdorëzua në polici më 15



janar dhe pak ditë më parë kërkoi gjykim të shkurtuar përmes avokatit mbrojtës, Theodori Sollaku. Në investigim nënvizohet fakti se trafiku i drogës ka të përfshirë persona që nga ish-kry-

etarët e komunave e deri tek ministrat në qeveri. Ky implikim sipas medias britanike i jep "forcë" këtij aktiviteti nga njëra anë dhe nga ana tjetër siguron mbrojtjen prej arrestimeve.

SHKURT

Droga? Shqiptari gjendet i vdekur në burgun e Greqisë

Një i burgosur tjetër u gjet të dielën i vdekur në Burgun e Korydallosit. Raportohet se shqiptari, identiteti i të cilit nuk bëhet me dije, është i treti që ka humbur jetën në një qel të veçantë të burgut gjatë ditëve të fundit në shtetin fqinj. Nga të dhënat e para mësohet se bëhet fjalë për një 33-vjeçar nga Shqipëria. Dëshmia e parë çon në përfundimin se vdekja e 33-vjeçarit erdhi nga droga. Megjithatë, është ekspertiza mjeko-ligjore që do të zbulojë shkaqet e saktë të vdekjes së të burgosurit.

Kapet 44-vjeçari shqiptar i kërkuar për trafik droge

Një shqiptar, i cili rrezultonite i shpallur në kërkim për trafik droge, është arrestuar në Itali. Mediat italiane raportojnë se në pranga ka përfunduar një 44-vjeçar nga Shqipëria, identiteti i të cilit nuk bëhet me dije. Ai ishte dënuar në mungesë me 8 vite e 10 muaj burg, ndërsa arratia e tij mori fund gjatë ditës së djeshme. Ndërkohë, oficerët italianë prej ditësh e mbanin nën vëzhgim shqiptarin, ndërsa prangosja e tij u bë pas një aksioni në një lokal në zonën e Corniglianos. Pas arrestimit, tashmë 44-vjeçari duhet të vuajë dënimin e dhënë nga drejtësia italiane.

Vdes në aksident rrugor shqiptari 22-vjeçar

Një aksident i tragjik i ka marrë jetën një shqiptari në Agazzana të Italisë mbremjen e së shtunës. Mësohet se viktimi është Klodian Murrizi 22 vjeç, i cili udhëtoi me një makinë tip "Toyota Rav 4", kur mjeti humbi kontrollin dhe u përmbys duke dalë nga rruga. Pas përmbysjes, fuoristrada shpërtheu në flakë duke i marrë jetën shqiptarit me banim në Gossolengo të Italisë. Mediat italiane raportojnë se përveç shqiptarit që humbi jetën, në mjet ndodhej edhe një person tjetër rreth 22 vjeç, i cili është dërguar në spital në gjendje të rëndë për jetën. Pas mbërritjes së ekipit zjarrfikës në vendngjarje është bërë e mundur filja e flakëve në mjet.

Ekstradohet në Belgjikë Alket Dauti

Prokurori: Rrezikonte jetë njerëzish për para

BRITANI

Kreu i një rrjeti të trafikimit të emigrantëve drejt Britanisë së Madhe është ekstraduar drejt Belgjikës për të shlyer dënimin me 10 vite burg dhe 720 mijë euro gjobë. Shqiptari Alket Dauti u arrestua në një aksion të zhvilluar në apartamentin e tij në jug të Londrës në qershor të vitit 2018. Arrestimi i tij ishte pjesë e një hetimi të përbashkët britanik-belg, ndërsa ai drejtonte një grup që dërgonin me kamionë burra, gra dhe fëmijë nga Belgjika drejt Britanisë kundrejt pagesës. Banda përdorte shoferë të korrupuar kamionësh për të marrë emigrantët në Belgjikë, të cilët i fusnin në Mbretërinë e Bashkuar nëpërmjet porteve të ndryshme. Banda dyshohet se trafikonte shqiptarë, të cilët paguanin shifra të mëdha parash për të qëndruar në hotele në Belgjikë përpara se të shkonin në Britani. "Përmes bashkëpunimit të ngushtë me policinë dhe



prokurorët federalë të Belgjikës, ne kemi goditur një grup të rëndësishëm të kriminit të organizuar; i përfshirë në sjelljen e emigrantëve në Britani në mënyrë të paligjshme. Dauti ishte kreu i atij grupi. Ai i trajtoi emigrantët e dëshpëruar si mall për të bërë

para. Ai nuk kishte marrë parasysh se jeta e tyre vihej në rrezik, pasi ata udhëtonin në anën e pasme të kamionëve. Ai është dënuar nga një gjykatë belge dhe ne e kemi ekstraduar atje për të kryer dënimin", - ka thënë prokurori që ka udhëhequr hetimet në Britani.

Historia e kapjes së grupit të trafikantëve në Angli

Në qershor të vitit 2018 një bandë trafikuesish qeniesh njerëzore u shkatërrua në Britani nga policia. Mes të arrestuarve ishte edhe kreu i kësaj bande, shqiptari Alket Dauti, shkruante "Daily Mail". Ky i fundit u arrestua në një aksion të zhvilluar në apartamentin e tij në jug të Londrës. Mediat britanike njoftuan se teksa e shoqëruan jashtë banesës me pranga në duar, ai iu drejtua një prej oficerëve me fjalët: "Ty të mbaj mend shumë mirë". Teksa po hipte në makinën e policisë, Dauti iu drejtua gazetarëve të britanikes "Standard" me fjalët: "Shkruani mirë për mua, kapët fotografi të mira"? Ky operacion është zhvilluar në disa vende të Europës, ndërsa u arrestuan 10 pjesëtarë të tjerë të kësaj bande. Ata përdornin shoferë të korrupuar kamionësh për të marrë emigrantët në Belgjikë, të cilët i fusnin në Mbretërinë e Bashkuar nëpërmjet porteve të ndryshme.



Mbledhja e Këshillit Bashkiak në 31 janar/ Vendimet që pritet të miratohen

Zbardhen emrat e 2924 familjeve që do të marrin ndihmë ekonomike

Lista e parë, ja kush do të përfitojë pagesë

Voltiza Duro

Në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës pritet që të miratohet edhe ndihma ekonomike për 2924 familje në kryeqytet. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e plotë të emrave që priten të marrin këtë pagesë, pas miratimit në mbledhjen e 31 janarit. Mes këtyre familjeve që do të përfitojnë ndihmën ekonomike, ka dhe per-



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

sona me statusin e jetimit, viktima të dhunës në familje, individë viktima të trafikimit apo edhe familjet me shumë fëmijë. "Kanë ap-

likuar për ndihmë ekonomike 2470 familje. Individë me statusin e jetimit 283 persona, me një fond 849000. Individë viktima të

trafikimit 5 persona, me një fond 15000 lekë, lista bashkëlidhur. Individë viktima të dhunës në familje 93, me një fond 279000, lista bash-

këlidhur", - theksohet në vendimin nr.1 të datës 15 janar 2019. Në këtë të fundit bëhet me dije se nga kjo ndihmë ekonomike do të përfitojnë edhe: Individë prindër të fëmijëve të lindur: trinjakë 17 familje, me një fond 153000 lekë. Katërnjakë 4 familje, me një fond 64000 lekë. Pesënjakë e më shumë njëherësh 1 familje, me një fond 25000 lekë. Fëmijë në kujdestari të një familje kujdestare 48 aplikime, me një fond 432000 lekë. Fëmijë me aftësi të kufizuar në kujdestari 3 aplikime, me një fond 30000 lekë. Në mbledhjen e 31

janarit të Këshillit Bashkiak të Tiranës, pritet të miratohet edhe projektvendimi për pagesën e personave me aftësi të kufizuar; si dhe miratimi i kompenzimit të çmimit të energjisë elektrike për kategori të përfutës. Gjithashtu do të jenë në shyrtyrim edhe projektvendimet për miratimin e familjeve përfutës dhe ndihmë nga programi i bllok-fondit nës ekonomike deri në 6 për qind si dhe miratimin e listave të nxënëseve të arsimit parauniversitar si dhe studentëve të arsimit të lartë që do të përfitojnë bursa për vitin mësimor 2018-2019.

Nr. Emri atesia mbiemri	Nr. dosje	Nr. anëtare	Nr. Emri atesia mbiemri	Nr. dosje	Nr. anëtare	Nr. Emri atesia mbiemri	Nr. dosje	Nr. anëtare	Nr. Emri atesia mbiemri	Nr. dosje	Nr. anëtare
Baldushk											
1 Abaz Aqif Kosta	NE-2018-099119	3	65 Fejzi Sadik Ahmetaj	NE-2018-116155	2	130 Refik Myftar Hyka	NE-2019-005768	4	193 Astrit Sabri Uruçi	NE-2015-007522	4
2 Agim Qamil Lloçi	NE-2017-026457	3	66 Ferdinand Nezir Balla	NE-2016-012586	3	131 Refik Adem Uku	NE-2016-039000	3	194 Bajram Behxhet Vaka	NE-2018-098309	4
3 Agim Avdi Lulja	NE-2015-012622	5	67 Ferdinand Tahsim Dapi	NE-2014-042160	4	132 Roland Elez Demarku	NE-2019-003528	4	195 Bardh Muharrem Muja	NE-2014-017295	5
4 Ahmet Velbi Kacollja	NE-2015-042598	4	68 Ferdinand Bajfjar Kosta	NE-2016-012665	4	133 Sabri Myslym Harizi	NE-2018-092170	4	196 Bashkim Musa Çullhaj	NE-2018-102712	3
5 Alban Ymer Greca	NE-2019-004982	3	69 Feride Ali Zela	NE-2015-042445	5	134 Sabri Ibrahim Kasa	NE-2018-109548	3	197 Bashkim Dalip Dugi	NE-2015-006689	3
6 Albert Xhemal Harizi	NE-2016-016377	6	70 Festim Rexhep Sala	NE-2016-038931	3	135 Sadik Islam Tafa	NE-2016-010055	4	198 Bashkim Bajram Sinakoli	NE-2017-025379	3
7 Albi Fadil Deliu	NE-2018-033789	4	71 Festim Allaman Tresa	NE-2014-031734	5	136 Sajmir Hasan Haka	NE-2018-002345	3	199 Bashkim Emin Taçi	NE-2015-042777	4
8 Alfrid Sherbet Ahmeti	NE-2016-027002	3	72 Fetah Nasuf Krasniqi	NE-2014-004750	8	137 Sali Shaqir Tafa	NE-2015-033514	5	200 Bedri Ibrahim Isufi	NE-2015-011674	3
9 Ali Qazim Greca	NE-2019-004956	2	73 Flamur Baki Allmuca	NE-2017-060519	4	138 Sami Zeqir Mela	NE-2014-016626	6	201 Besnik Osman Alla	NE-2014-011266	5
10 Ali Bajram Zela	NE-2014-019194	4	74 Gazmend Halli Çullhaj	NE-2019-005751	4	139 Sefer Mustafa Dapi	NE-2015-011546	3	202 Besnik Idriz Bashka	NE-2014-006163	5
11 Alma Alush Barmeta	NE-2016-025642	3	75 Genc Ali Ahmeti	NE-2015-006675	5	140 Sefer Shelqet Qehaj	NE-2019-003623	4	203 Besnik Oemal Qefalia	NE-2014-019964	5
12 Arben Zyhidj Stafa	NE-2017-061739	4	76 Genc Hamid Allmuca	NE-2017-016850	3	141 Selami Allaman Balla	NE-2014-016817	7	204 Bilal Hamza Selba	NE-2015-037902	5
13 Arben Ferhat Vrapci	NE-2016-015637	4	77 Genc Mersin Shabanaj	NE-2014-013202	4	142 Shelqet Ramadan Osmani	NE-2015-015821	4	205 Dashamir Muharrem Begteshi	NE-2018-109922	4
14 Ardian Fadil Deliu	NE-2016-022988	4	78 Gezim Ali Kasa	NE-2016-013604	5	143 Sherbet Haxhi Pojana	NE-2014-009320	5	206 Dashamir Musa Çeça	NE-2015-016919	4
15 Ardian Lali Xhepa	NE-2016-007914	5	79 Gezim Ahmet Sina	NE-2014-004567	6	144 Sherbet Halim Uku	NE-2018-093416	3	207 Dile Hysen Hidri	NE-2017-063845	1
16 Arian Ali Allmuca	NE-2016-020247	5	80 Goslijan Bajram Balla	NE-2014-005613	5	145 Shkelqim Ali Hakkballa	NE-2014-044067	3	208 Durim Xhaferi Balla	NE-2014-041251	5
17 Arjan Hysen Sula	NE-2016-038987	4	81 Halli Qamil Uku	NE-2017-013297	4	146 Shkelqim Halli Karaj	NE-2014-012717	6	209 Eduart Xadi Salaku	NE-2014-011320	5
18 Armand Junaj Harizi	NE-2018-107633	3	82 Hali Hekuran Elsiina	NE-2016-009930	2	147 Shkelqim Sherif Osmani	NE-2016-007942	3	210 Elmaz Ahmet Byku	NE-2019-007544	4
19 Artan Bonuz Karaj	NE-2019-002668	4	83 Hari Bajram Lloçi	NE-2017-047453	3	148 Shkelqim Islam Xhani	NE-2016-002035	6	211 Elmaz Nezir Çeça	NE-2015-014928	5
20 Artan Shkurt Qehaj	NE-2018-097471	3	84 Haxhi Mural Ahmetaj	NE-2016-020085	6	149 Shpetim Muharrem Lloçi	NE-2018-106385	4	212 Fadil Xhemal Çakri	NE-2019-001715	2
21 Artan Hali Sejdimi	NE-2018-03851	4	85 Hekuran Islam Hamali	NE-2015-044006	6	150 Shpetim Cane Qehaj	NE-2014-044415	5	213 Fadil Xhemal Xhan	NE-2018-050489	6
22 Astrit Cane Qehaj	NE-2016-010096	4	86 Hysen Isuf Allmuca	NE-2018-078111	7	151 Shpetim Petrli Tresa	NE-2016-012360	5	214 Fadil Osman Hoxha	NE-2014-008385	5
23 Bafjar Shkurt Kosta	NE-2016-009860	4	87 Idajet Hamit Ymeri	NE-2017-006600	4	152 Shpetim Shelqet Vogli	NE-2015-043419	4	215 Fadil Ahmet Uruçi	NE-2018-091501	3
24 Bajram Hajdar Greca	NE-2018-000864	3	88 Ili Hali Ramushi	NE-2016-038236	3	153 Shyqyri Mahmut Uku	NE-2017-018683	6	216 Farie Qani Banaj	NE-2019-005091	2
25 Bajram Baki Merja	NE-2018-111258	4	89 Ilir Shaban Sula	NE-2017-005308	5	154 Shyqyri Demir Demarku	NE-2015-020717	3	217 Fatbardha Sefer Hoxha	NE-2018-115162	3
26 Bajram Besim Muehshaj	NE-2016-024626	4	90 Ilmi Ali Zela	NE-2014-019287	4	155 Sulejman Banush Ibra	NE-2019-003793	2	218 Fatmir Sali Hidri	NE-2018-093718	5
27 Bardhyl Muharrem Ramushi	NE-2014-004480	2	91 Ismail Kadri Uku	NE-2018-002386	3	156 Suzana Qazim Lloçi	NE-2018-105572	4	219 Fatmir Ahmet Tafani	NE-2018-102394	2
28 Bastri Zeqir Mela	NE-2015-043463	5	92 Ismail Kadri Uku	NE-2018-002386	3	157 Tomor Ali Ahmeti	NE-2016-025605	4	220 Fatmire Islam Lloçi	NE-2014-009868	4
29 Bedri Shelqet Barmeta	NE-2014-008372	6	93 Jemin Hysen Canja	NE-2015-043313	5	158 Tomor Zyhidj Kateshi	NE-2014-017207	4	221 Fatme Adem Kasa	NE-2015-040081	5
30 Bedri Ahmet Zela	NE-2016-019073	3	94 Lavdim Zija Kateshi	NE-2015-031789	5	159 Tomor Zyhidj Kateshi	NE-2014-017207	4	222 Ferit Miris Çela	NE-2018-096580	4
31 Behar Ruzhdi Mela	NE-2015-011303	4	95 Lazime Elez Gjiana	NE-2019-005266	6	160 Tomor Zyhidj Kosta	NE-2018-102621	4	223 Ferit Miris Çela	NE-2018-096580	4
32 Behare Shkelqim Elezi	NE-2018-111027	4	96 Leonard Hamza Lloçi	NE-2019-003829	4	161 Veiz Skender Allmuca	NE-2018-057471	4	224 Fiqri Hajdar Abdjia	NE-2014-037013	3
33 Besim Nezir Lulja	NE-2015-043224	5	97 Luan Trandafil Allmuca	NE-2015-003411	5	162 Veiz Kadri Uku	NE-2014-003423	5	225 Fiqri Islam Zeqiri	NE-2014-026195	5
34 Besim Sali Ramushi	NE-2017-047595	3	98 Luan Qerim Dapi	NE-2018-031453	6	163 Velbi Mehmet Kacollja	NE-2018-064866	3	226 Floria Hysmet Sherifli	NE-2014-045336	4
35 Besnik Shelqet Ibrahili	NE-2018-109241	6	99 Luan Shkurt Hoxha	NE-2016-013161	4	164 Viktor Hajrulla Shabanaj	NE-2016-038913	4	227 Gazmend Abdulla Alla	NE-2015-031635	5
36 Besnik Hekuran Kodra	NE-2018-004308	3	100 Luan Baki Vrapci	NE-2017-027482	4	165 Viktor Nevruz Sina	NE-2015-028612	4	228 Genc Fadil Kodra	NE-2019-004443	3
37 Besnik Ahmet Tafa	NE-2017-052956	6	101 Lutizim Fadil Deliu	NE-2014-009855	4	166 Viktor Nevruz Sina	NE-2016-041359	6	229 Genjan Vahid Haku	NE-2017-067484	4
38 Bujar Petrli Elezi	NE-2018-093485	4	102 Lutizim Hamdi Kateshi	NE-2017-037739	4	167 Vladimir Shkurt Xhani	NE-2014-005987	5	230 Gezim Abdi Byku	NE-2018-112768	3
39 Bujar Myftar Hyka	NE-2015-016418	4	103 Lutizim Ibrahim Kazhaja	NE-2016-016959	5	168 Xhavit Fetah Ibrahili	NE-2018-040568	3	231 Gezim Isuf Gaci	NE-2014-019996	3
40 Bujar Sefer Kodra	NE-2017-057553	5	104 Mehmet Ramadan Osmani	NE-2015-027235	4	169 Xhavit Fetah Ibrahili	NE-2018-040568	3	232 Gezim Selim Haluli	NE-2014-008708	4
41 Bujar Muharrem Lloçi	NE-2016-015159	5	105 Mexhit Riza Shabanaj	NE-2016-009518	3	170 Xheshmir Vllasi	NE-2014-005664	5	233 Gezim Ibrahim Hasa	NE-2015-011267	3
42 Bujar Hysen Sina	NE-2016-005302	4	106 Migena Hamdi Greca	NE-2016-014110	4	171 Xheshmir Vllasi	NE-2014-005664	5	234 Gezim Ismail Kodra	NE-2018-104734	4
43 Buletmire Ibrahim Qehaj	NE-2017-055974	6	107 Milat Selman Sina	NE-2015-017526	5	172 Xhevdir Zeqir Mela	NE-2018-089559	4	235 Gezim Haxhi Xhani	NE-2014-024430	3
44 Dashamir Qamil Lloçi	NE-2016-043765	4	108 Muharrem Baki Allmuca	NE-2018-040079	4	173 Xheshmir Ismail Vogli	NE-2014-033845	5	236 Hajdin Dalip Xhani	NE-2018-099936	3
45 Dritan Besim Gjaja	NE-2014-037027	3	109 Muharrem Beqir Harizi	NE-2018-097516	3	174 Ylber Baki Vrapci	NE-2016-019130	3	237 Haki Hemedi Kasa	NE-2015-033500	6
46 Dritan Ruzhdi Mela	NE-2015-037914	4	110 Mural Shelqet Qehaj	NE-2017-034042	3	175 Ylli Rustem Beti	NE-2016-012428	4	238 Halit Xhami Hoxha	NE-2018-116254	2
47 Durim Bedri Plaku	NE-2017-059762	5	111 Mustafa Qazim Lika	NE-2018-048357	7	176 Zyber Adem Uku	NE-2019-001458	2	239 Halli Kaplan Lulja	NE-2018-036798	3
48 Durim Fadil Shahini	NE-2016-010765	5	112 Nazif Mahmut Tafa	NE-2015-012782	4	177 Zyhidj Mustafa Tresa	NE-2018-004170	6	240 Halli Adem Sinakoli	NE-2015-038625	4
49 Dylbere Ramadan Nuri	NE-2018-102760	7	113 Ndrizim Bajram Kaxhaja	NE-2016-020372	3	Berzhite			241 Hamid Banush Hoxhaj	NE-2016-002815	3
50 Edmond Haxhi Balla	NE-2016-010714	4	114 Neritil Harif Canja	NE-2014-006236	6	178 Abdulla Ali Byku	NE-2015-036211	3	242 Hamide Ali Misku	NE-2018-102437	2
51 Eduard Bexhet Ahmetaj	NE-2017-063517	5	115 Nevruz Ferhat Tuda	NE-2016-016309	6	179 Afrim Xhemal Kasa	NE-2017-044711	4	243 Hamit Sali Bozha	NE-2014-018469	6
52 Eduard Shagir Tufa	NE-2018-014464	4	116 Nexhmije Selim Çullhaj	NE-2016-043342	4	180 Afrim Xhami Mela	NE-2014-007293	5	244 Hamza Zahir Haxhi	NE-2015-043212	4
53 Elez Demir Demarku	NE-2018-101143	3	117 Niko Mural Ahmetaj	NE-2018-075133	4	181 Agim Sabri Çela	NE-2014-011114	5	245 Hasan Islam Çakri	NE-2014-010043	6
54 Elton Qamil Lloçi	NE-2018-091492	3	118 Olsi Rexhep Lloçi	NE-2017-026437	3	182 Agim Sabri Çela	NE-2014-011114	5	246 Hasan Ferid Çullhaj	NE-2014-043565	4
55 Enver Caus Hamati	NE-2015-030792	4	119 Perparim Qazim Greca	NE-2018-028546	4	183 Albert Fadil Dugi	NE-2015-008014	3	247 Hatixhe Haziz Kaca	NE-2018-098779	3
56 Enver Rexhep Lloçi	NE-2018-093443	7	120 Perparim Shaban Hamali	NE-2017-019577	7	184 Albert Emin Kodra	NE-2015-005287	3	248 Haxhi Selim Haluli	NE-2014-036609	4
57 Ervin Oemal Balla	NE-2016-019046	3	121 Perparim Iljaz Harizi	NE-2017-065513	4	185 Ali Ismail Byku	NE-2014-021227	5	249 Haxhi Osman Luzi	NE-2015-015449	4
58 Ervin Tahir Nuri	NE-2018-072075	4	122 Petrli Mahmut Begu	NE-2018-072182	3	186 Ali Ismail Hoxhaj	NE-2014-014307	5	250 Hysni Xhemal Kasa	NE-2017-044723	4
59 Fan Islam Tresa	NE-2018-105525	3	123 Petrli Qazim Ramushi	NE-2018-015136	3	187 Ali Qazim Nasufi	NE-2014-006967	4	251 Hysni Sheqyri Nasufi	NE-2016-000454	4
60 Fatbardh Ramadan Hasa	NE-2019-004806	5	124 Pranvera Ramadan Tafa	NE-2015-020682	4	188 Altirim Lulajza Dugi	NE-2015-031376	3	252 Ibrahim Selim Abdjia	NE-2017-033581	4
61 Fatmir Allaman Balla	NE-2018-092497	4	125 Pucio Rustem Beti	NE-2015-020682	4	189 Arif Muharrem Sinakoli	NE-2015-011213	6	253 Idajet Nesheet Qefalia	NE-2014-014456	5
62 Fatmir Nezir Kodra	NE-2018-116229	4	126 Qemal Herjan Balla	NE-2015-043631	3	190 Arif Zemer Alla	NE-2014-014179	3	254 Ilir Muharrem Begteshi	NE-2017-063557	4
63 Fatos Ali Beli	NE-2019-003739	4	127 Qemal Shyken Ibrahili	NE-2014-010801	3	191 Aslan Mustafa Hysyalu	NE-2016-012156	5	255 Ilir Sulejman Kasa	NE-2014-014193	5
64 Fatos Zyber Vrapci	NE-2019-001698	4	128 Qemal Halli Mela	NE-2017-056070	4	192 Aslan Islam Zeqiri	NE-2015-028010	5	256 Ilir Hysen Lika	NE-2015-040405	4

Table with 4 columns: ID, Name, Address, and Phone Number. It lists various individuals and organizations, such as Ilir Said Nasufi, Ilmi Fadil Duqi, and others, with their respective contact information.

716	Besnik Muharrem Lami	NE-2014-007053	5	828	Naxhije Nevruz Aliu	NE-2018-002551	1	942	Manushaqe Xhemal Sula	NE-2019-003922	1	1055	Fatime Rexhep Mancellari	NE-2017-040803	1
717	Bitat Arif Saliu	NE-2014-007840	4	829	Pellumb Mustafa Aliaj	NE-2018-091285	2	943	Marina Kofi Mali	NE-2018-053696	1	1056	Fatmir Muharrem Buzo	NE-2017-066810	1
718	Bujar Ramazan Taçi	NE-2018-002858	5	830	Perparim Gani Kaculi	NE-2016-019600	5	944	Marina Frelid Arxhivu	NE-2018-041196	1	1057	Fatim Alush Çullhaj	NE-2018-119552	1
719	Dashamir Sabri Saliu	NE-2017-047344	6	831	Pirjan Diell Hallikondani	NE-2018-107573	4	945	Malida Aslan Cakri	NE-2018-014978	3	1058	Fatos Ali Hoxha	NE-2016-013811	1
720	Donika Gazi Kurtzej	NE-2019-002445	1	832	Pjeter Ndue Palaj	NE-2015-027919	7	946	Melisa Fadil Kasemi	NE-2018-101674	1	1059	Ferdinand Tiri Dibra	NE-2016-011738	5
721	Durim Ismail Veljia	NE-2015-041453	5	833	Pranvera Petriti Prendi	NE-2018-111934	4	947	Mustafa Riza Idri	NE-2018-117562	1	1060	Fiona Endris Stuli	NE-2018-058269	1
722	Eduart Emri Taçi	NE-2015-022170	4	834	Preng Gjet Lurthi	NE-2017-039542	4	948	Mustafa Jonuz Leka	NE-2018-038114	4	1061	Flajo X Nasulli	NE-2017-019318	1
723	Elez Sali Sefa	NE-2018-002877	5	835	Rezart Ylli Durmishi	NE-2019-004830	1	949	Naim Maslem Shira	NE-2014-013503	5	1062	Flutura Bajram Skura	NE-2014-007683	5
724	Enver Arif Saliu	NE-2014-056033	4	836	Sajmir Abdulla Deda	NE-2014-001897	4	950	Nik Pal Lieshi	NE-2016-024354	3	1063	Gani Ali Cani	NE-2016-022536	4
725	Fatmir Qamil Deliu	NE-2018-093634	2	837	Serxho Ermal Tufa	NE-2018-075598	1	951	Olimbi Jani Reku	NE-2018-112511	1	1064	Genljan Reis Prifti	NE-2018-073743	6
726	Fatos Savel Cupi	NE-2019-002686	4	838	Shakira Hektor Sula	NE-2018-059510	1	952	Redina Hekuran Cjapi	NE-2019-005252	1	1065	Haxhi Oemal Xhemali	NE-2019-005141	3
727	Fatos Sali Hidri	NE-2014-000859	9	839	Shpetim Haxhi Berisha	NE-2019-005735	7	953	Riza Mustafa Idri	NE-2017-062243	3	1066	Haziz Muharrem Bega	NE-2019-005209	3
728	Fiqirete Faik Mama	NE-2016-004869	1	840	Shyqiri Hajri Abdylit	NE-2018-099776	3	954	Riza Rifat Singej	NE-2019-000411	3	1067	Ilir Mahmut Kurushi	NE-2019-003649	3
729	Fiqiri Veli Almadhi	NE-2014-050363	6	841	Sufjan Hektor Sula	NE-2018-059596	4	955	Rozina Zef Kurtuka	NE-2018-062069	5	1068	Ilijada Romeo Gici	NE-2015-012944	4
730	Fiqiri Petriti Hysyalu	NE-2017-015316	3	842	Tomor Skender Uka	NE-2016-005985	1	956	Safa Mehdi Korbi	NE-2014-056165	5	1069	Irina Alushi	NE-2014-002098	1
731	Hysni Petriti Hysyalu	NE-2017-031256	3	843	Xhafer Hasan Bajrami	NE-2018-026001	3	957	Saimir Rustem Shaqiri	NE-2018-090319	1	1070	Julia Arbin Bashkurti	NE-2016-008325	1
732	Ilir Jonuz Ajazi	NE-2016-008443	5	844	Xhenni Vangjush Kushjini	NE-2018-105280	1	958	Saverjo Genc Daci	NE-2017-027693	2	1071	Kevin Arbin Bashkurti	NE-2016-068300	1
733	Ilir Xhemal Selba	NE-2018-106598	4	845	Xhesisda Zzzzz Sefa	NE-2018-098167	1	959	Selda Imran Hoxhallari	NE-2018-049652	1	1072	Klevis Xhiss Nega	NE-2017-043867	1
734	Ilirjan Riza Taçi	NE-2016-007307	4	846	Xhillek Tahir Zhugri	NE-2018-099897	1	960	Seid Emir Luka	NE-2015-021051	1	1073	Klodiana Cilrim Spahiu	NE-2018-120049	1
735	Indrit Kadri Likrama	NE-2014-055891	9	847	Zana Safet Rakipi	NE-2018-059259	7	961	Sokol Daut Ukadshi	NE-2014-001262	6	1074	Kujtim Ethem Hareçari	NE-2019-003889	3
736	Ishe Adem Qemall	NE-2018-107891	2	848	Zhuljeta Shyqiri Basho	NE-2018-045011	7	962	Suela Emri Luka	NE-2015-021093	1	1075	Kujtim Ali Haçi	NE-2018-100096	1
737	Ismail Sulejman Basho	NE-2016-016438	4	Minibashkia Nr. 10				963	Suzana Naim Rika	NE-2018-074897	1	1076	Lek Gjon Stanaj	NE-2019-006670	3
738	Jetmir Hasan Rrumbullaku	NE-2016-039488	5	849	Anila Murat Gjika	NE-2018-118118	4	964	Tonin Pashk Stojani	NE-2018-118785	4	1077	Leonora Ali Çelaj	NE-2019-007763	1
739	Kalem Xhemal Selba	NE-2018-096857	3	850	Arben Begir Bega	NE-2018-117776	3	965	Vera Ibrahim Shkemberi	NE-2017-016939	1	1078	Luan Fadil Hasa	NE-2019-000735	1
740	Krisljan Shaqir Saliu	NE-2018-099175	4	851	Arben Panjohur Ludi	NE-2018-083053	5	966	Vjollca Nazmi Lasku	NE-2018-095527	3	1079	Marinela Demir Çela	NE-2018-065803	3
741	Kujtim Xheila Risika	NE-2018-112366	4	852	Arben Miter Pervataj	NE-2019-005485	5	967	Xheni Fadil Lulija	NE-2015-015819	1	1080	Migena Refik Hoxha	NE-2018-106875	1
742	Kujtim Riza Taçi	NE-2018-002404	5	853	Arti XXXXXX Mema	NE-2018-055192	1	968	Xhësika Flamur Manuka	NE-2014-055370	2	1081	Migena Naun Toli	NE-2018-091360	1
743	Lavdie Osman Veljia	NE-2018-080251	3	854	Astrit Zera Deshiku	NE-2019-005524	4	969	Xhulljeta Emri Luka	NE-2015-021158	5	1082	Pandora Ylli Xhumari	NE-2016-008733	1
744	Liljana Meslim Haka	NE-2017-063063	5	855	Blerit Kashtit Braho	NE-2016-021075	1	970	Zabit Hysen Dragoshi	NE-2015-010094	4	1083	Rei Shyqiri Kurti	NE-2018-096448	1
745	Luan Ramazan Ajazi	NE-2016-015683	5	856	Bora XXXX Deliu	NE-2017-065902	1	Minibashkia Nr. 2				1084	Romeo Romeo Gici	NE-2014-034322	1
746	Lulezim Abdulla Deda	NE-2018-109448	6	857	Driana Kashtit Braho	NE-2016-020110	1	971	Adriana Islam Korca	NE-2018-029225	3	1085	Sabrije Idri Luka	NE-2014-000781	4
747	Lulzim Rexhep Shaha	NE-2018-097479	5	858	Edmond Ymer Haveri	NE-2019-005354	4	972	Agron Lula Nurka	NE-2018-044151	4	1086	Servete Faiz Nega	NE-2018-034528	1
748	Lutif Jonuz Ura	NE-2018-109378	4	859	Emra XXXX Male	NE-2018-065588	1	973	Aleksandra Fatbardh Meta	NE-2018-013856	4	1087	Shaban Rap Shkoza	NE-2018-119578	1
749	Mehdi Dalip Mullameti	NE-2018-100566	5	860	Enkeledda Gjergji Peçi	NE-2015-039643	1	974	Ali Kurt Popall	NE-2018-096224	1	1088	Shpetim Muhareom Solomeni	NE-2019-006667	2
750	Orestis aridian tafa	NE-2015-005127	1	861	Ervin Reshat Sula	NE-2018-120494	9	975	Altea Xh Agolli	NE-2014-041383	2	1089	Skender Abdyl Muza	NE-2018-004103	3
751	rudin Agim Duqi	NE-2014-013410	4	862	Fatbardha Besnik Xhafta	NE-2018-118808	2	976	Amanda Amarillo Sula	NE-2018-064862	1	1090	Spanjola Spartak Nasufi	NE-2017-039902	1
752	Sadik Hysen Myzyri	NE-2018-102538	3	863	Fatmir Muharem Bardhi	NE-2018-118327	1	977	Arjan Kadri Brajha	NE-2018-068352	5	1091	Spartak Shefqet Duka	NE-2018-075864	5
753	Shaqir Sulejman Veljia	NE-2019-005280	3	864	Florina Klodian Pasmaciu	NE-2014-033852	2	978	Avni Aslan Bendaj	NE-2015-027532	1	1092	Suzana Safet Xhezo	NE-2018-101657	1
754	Shpetim Bajram Rakkollari	NE-2018-113399	3	865	Jaho Sali Bardhoshi	NE-2019-007066	1	979	Avni Mehmet Bermeta	NE-2018-078601	5	1093	Violeta Piro Duka	NE-2016-030023	1
755	Skender Hasan Veljia	NE-2018-120321	2	866	Jurgen XXXX Deliu	NE-2017-065985	1	980	Avni Hamid Keçi	NE-2018-105598	4	1094	Vladimir Ramazan Bekteshi	NE-2016-066653	5
756	Sulejman Adem Haka	NE-2019-006081	2	867	Kejssi XXXX Isufi	NE-2018-117659	1	981	Bajram Mehmet Hasani	NE-2018-097365	1	1095	Xhafer Shaban Mansaku	NE-2018-117662	1
757	Vasfi Zenel Ruzja	NE-2018-101455	4	868	Marjana Ilo Polena	NE-2017-028389	1	982	Bajram Ahmet Ibrahimji	NE-2018-093810	1	1096	Zofe Bajram Kamberi	NE-2016-011738	1
758	Veiz Xhemal Balla	NE-2016-010172	3	869	Nurije Ethem Liani	NE-2014-046306	1	983	Bashkim Demir Biba	NE-2016-014625	5	Minibashkia Nr. 4			
759	Xhemal Petriti Hysyalu	NE-2018-101455	4	870	Perparim Fatmir Bekollari	NE-2019-007228	2	984	BASHKIM MEXHID TULLJA	NE-2018-010252	3	NE-2018-055476	3		
760	Xhedvet Riza Kovaci	NE-2014-054048	3	871	Petri Artur Dogga	NE-2019-002998	1	985	Belul Jashar Leka	NE-2018-120558	5	NE-2016-018996	4		
761	Zeqir Zyber Tarja	NE-2015-042339	4	872	Sandi Jorgji Koci	NE-2018-117863	2	986	Burbeqe Muharem Memushi	NE-2018-106466	4	NE-2019-052492	4		
Lagjia Nr. 14 (Unaza e Re)				873	Stela Tahir Muçaj	NE-2018-082450	3	987	Demir Mahmut Qinami	NE-2014-033627	2	1100	Adriatik Tahir Kotolloshi	NE-2019-004082	7
Lagjia Nr.12 (Fresku)				874	Viosa Shaban Berisha	NE-2014-004313	4	988	Denora Sokrat Kapaj	NE-2018-100748	4	1101	Adriatik Shaban Ramadani	NE-2015-004795	7
Lagjia Nr.13 (Kodra e Delliit)				875	Xhefiri Eduart Lekdushi	NE-2017-064272	1	989	Edmond Shefqet Xhebrahimi	NE-2014-012190	9	1102	Adriatik Isuf Shahaj	NE-2015-041274	1
Minibashkia Nr. 1								990	Ejsi ---- Pashollari	NE-2018-108333	1	1103	Aferdita Hamit Berliku	NE-2018-102553	1
762	Adnan Haxhi Cerina	NE-2016-018120	6	876	Adelina Kadri Gaxha	NE-2018-111742	3	991	Elez Ali Marku	NE-2019-002431	2	1104	Agim Bardhyl Habili	NE-2018-012182	4
763	Ajdi Shuaip Lamce	NE-2018-090982	1	877	Agim Kamber Hysaj	NE-2018-117520	2	992	Emir Abdulla Bajrami	NE-2016-024751	5	1105	Agim Petriti Likaj	NE-2019-003716	5
764	Albert Petriti Ibrahimji	NE-2017-043783	6	878	Agron Xhavit Arapi	NE-2018-104278	2	993	Ernis Nu_Zezullon Corbahxhiu	NE-2018-058612	1	1106	Albana Xheladim Nexhipi	NE-2017-066123	1
765	Alma Hamza Sula	NE-2018-092736	4	879	Agron Fadil Lushnja	NE-2017-045187	5	994	Eva Marin Sula	NE-2018-067491	1	1107	Aleko Shokol Durri	NE-2018-088953	2
766	Altin Hysni Bala	NE-2018-096340	4	880	Alban Demir Zahaja	NE-2017-066668	4	995	Evgenji Lambrir Rrapi	NE-2017-066474	1	1108	Alketa Ili Tahiri	NE-2018-014061	5
767	Amandi Rajmond Daka	NE-2017-031440	1	881	Alesia Mariglien Hamza	NE-2017-018091	1	996	Fatbardha Nam Lahi	NE-2018-009995	5	1109	Alma Besim Karimani	NE-2019-006085	1
768	Antonio Imaginari Sinani	NE-2018-066865	1	882	Alketa Fadil Mulliti	NE-2018-074079	1	997	Fatmir Shuco Lapi	NE-2018-100603	1	1110	Altin Fadil Hyseni	NE-2017-031600	7
769	Antonios X Qerimi	NE-2016-002468	1	883	Alma Hiqmet Beqiri	NE-2019-001792	1	998	Fatmir Shezai Shytlaj	NE-2019-000087	1	1111	Amirido Kujtim Ruçja	NE-2017-017214	5
770	Arben Demirin Mehmeti	NE-2018-008649	4	884	Amia Klaus Meta	NE-2018-061131	1	999	Fiqiri Mustafa Tresa	NE-2015-017192	4	1112	Andon Xhafer Subashi Pacelli	NE-2015-005878	1
771	Arben Ahmet Zerellari	NE-2018-100481	3	885	Anila Haqil Markola	NE-2018-098394	1	1000	Gazim Imerr Miftitari	NE-2017-060122	1	1113	Andrea Panjohur Dibra	NE-2018-112432	1
772	Ardit Gaci Çaci	NE-2016-019402	5	886	Anjel Miri Hoxhallari	NE-2018-053752	1	1001	Greta Hulum Ponde	NE-2019-000043	1	1114	Anila Dilaver Roka	NE-2016-042472	5
773	Arjan Tashim Mehmeti	NE-2017-002834	8	887	Arben Demir Zekaja	NE-2014-048791	7	1002	Helit Shukri Kola	NE-2015-016971	5	1115	Antonio Zvez Hoxha	NE-2016-003053	1
774	Arsiela Ermal Tufa	NE-2018-075567	1	888	Arind Fadil Kasemi	NE-2018-101439	1	1003	Hrislinda Gezim Qallaj	NE-2016-022125	4	1116	Arben Nexhat Tare	NE-2019-003608	1
775	Artan Namik Kufi	NE-2018-053424	5	889	Aron Miri Hoxhallari	NE-2018-049659	1	1004	Hida Hysen Arapi	NE-2018-118788	1	1117	Armando Bashkim Rexha	NE-2017-042499	2
776	Bashkim Sulejman Bilbilii	NE-2016-014867	1	890	Artan Ali Lushnja	NE-2017-064200	4	1005	Ilia Xux Muca	NE-2018-057704	1	1118	Artur Avni Sula	NE-2015-042884	4
777	Bashkim Fejzi Zaka	NE-2019-005327	6	891	Artur Skender Mara	NE-2018-013355	6	1006	Josef Sinan Zotaj	NE-2018-107114	1	1119	Bashkim Mahumd Koka	NE-2018-120510	3
778	Bjeshke Ritar Ademi	NE-2016-021012	6	892	Artur Ruzhdi Xhambazi	NE-2019-000162	5	1007	Kadri Elvir Osmaj	NE-2015-031102	2	1120	Bashkim Ali Serjani	NE-2016-000248	6
779	Bledis Tomor Kasa	NE-2018-031813	1	893	Astrit Shkelqim Patogu	NE-2016-011777	2	1008	Korab Qazim Vata	NE-2015-007452	5	1121	Behije Ahmet Kazaferi	NE-2017-002485	1
780	Brajan Buçaj Elezaj	NE-2018-058915	1	894	Bardhe Ndrac Ukcejaj	NE-2019-002831	3	1009	Kujtim Fadil Meta	NE-2018-109386	3	11			

SHKRIMTARI RREFIME

Ekskluzive/ Kujtimet e shkrimtarit të njohur, Zija Çela, për dy nga miqtë dhe kolegët e tij, patriarkun e letrave shqipe dhe shkrimtarin me famë botërore

Me Dritëroin dhe Kadarenë në kafe "Pjaca"


Nga Zija Çela

Kur u bë përrimi i librit me tregime "Njerëz të krisur" të Dritëro Agollit, në sallën e ish-Lidhjes së Shkrimtarëve ligjëroi shumëkush. Dihet, sado të restaurohet, tavani i asaj salle do të vazhdojë të ruajë blazë tymi, jo nga i cigareve, por nga tymi i fisekz-jarrëve. Për Dritëroin, megjithatë, mund të flisja, por mes atij zjarrmllëku nuk m'u dha ta merrja fjalën. Nga leximi i librit më kishte lindur një pyetje, përgjigjen e së cilës ende s'ia kisha dhënë vetes dhe nuk po e dëgjoja as aty. Pyetja ishte: Çfarë ka moderne në klasiken e këtij autori, një moderne disi enigmë sepse, bie fjala, nuk e gjen të shfaqur as në strukturat e formës?

Pas ca kohësh, bëra një shkrim që e titullova "Leximi i një teksti univok" ('Drita', shtator 1995). Sapo u lexua në dorëshkrim, me fjalën univok qysh në titull, në redaksi u shfaqën dyshime se Dritëroito do t'i mbetë

“
Isamilin e kam lexuar herët dhe jam shprehur qysh herët për krijimtarinë e tij. Po kujtoj vetëm një rast. Njëherë, duke synuar të shpjegoja çelësin se si duhet lexuar vepra e Kadaresë, në një ese bëja referime me autorë perëndimorë, që atëherë mallkoheshin me të madhe te ne.

Rudolf Marku: Zija Çela, me një guxim prej të marri ia vesh drejt e në faqet e gazetës, duke krahasuar veprën e Kadaresë me atë të Orwell-it dhe të Prustit



Zija Çela

hatri. Nuk e di përse, por në mendoja ndryshe. Në atë shkrim pohoja se, sipas meje, Agolli u përket shkrimtarëve që dëshmojnë rezistencë konservuese në rrugën e tyre, duke i besuar më tepër rezultatit sesa kërkimit dhe eksperimentit. Prandaj është i qëndrueshëm në mënyrën e shkrimit të letërsisë. Në prozat e tij, lexuesi shkollar edhe sot i gjen me lehtësi të ashtuquajturat elemente të kompozicionit, hyrjen, pikën lidhëse, zhvillimin e ngjarjeve, pikën kulminante dhe zgjidhjen e veprimit. Në raportet e tij me lexuesin, i prirur njëherësh nga ideologjia dhe filozofia, Dritëroi shkruan

një letërsi të orientuar. Ai nuk e fsheh, përkundrazi, duket se bën përpjekje të vijueshme që nga tërësia e tekstit dhe përfundimi i tij, lexuesi të marrë po atë mesazh për të cilin ka shkruar autori.

Po aherë si shpjegohet ajo ndjesi moderniteti që, prapëseprapë, të vjen prej këtij shkrimtari teksa lexon prozën e tij? Nëse Dritëroito i mungon polilemantika dhe interteksti, atë e bën modern teksti univok që, për hir të prirjeve të këtij shkrimtari, mbart një vetjakësi të paimitueshme. Po të ishte thjesht një realist i traditës, Dritëro Agolli do t'i duhej të



Zija Çela me Dritëro Agollin



Zija Çela me kolegë

parapëlqente sidomos vijën e mesit, në kuptimin se çfarë është e besueshme në jetë, bëhet më e besueshme edhe në letërsi. Mirëpo Dritëroito, si në tregime ashtu edhe në romanet e tij jep kuota të skajshme, nevralgjike, pika të vlimit. Pa u shquar për trille fluturuese të fantazisë, ai dallohet për zgjedhjet kapriçoze që qëmton nga jeta. Ja përse, ndonëse të shkruara me qëllime univoke, romanet dhe tregimet e tij afrojnë me vepra që japin mundësi për lexime e interpretime të ndryshme, siç ndodh në

formacionet e artit modern. E kjo buron edhe nga paradoksi midis "fundit të mbyllur", çka pritet të Dritëroito dhe "fundit të hapur" që gjithsesi e shoqëron prozën e tij, duke nxitur tërheqje. Nëse te Brehtit ky shartim gjendet i përpunuar estetikisht në mënyrë të vetëdijshme, Dritëroito sikur i shpëton nga duart, ai e ka instinktiv dhe spontan. Ndoshta pikërisht intuita e artistit, në konflikt me metodën, u ka dhënë jetë kaq të gjatë edhe Zyllos së famshëm e Mato Grudës me top.



Zija Çela



Kishin kaluar disa ditë nga botimi i shkrimit kur, në trotuarin buzë gjelbërimit të "Pjacës", po çapitesha me mikun tim Lazër Stani. Nuk vonon e përballë shfaqet Dritëroi. Dhe Lazri, që deri atë çast as ma kishte hapur atë temë, por i mësuar me shakatë qesh e ngjesh, ia fut me top: "Hë, Dritëro, e pe si ta kish të hedhur Zijai me tekstin univok"?!

Prej asaj përskuqjes së tij finike, kur nuk i vinte nga tensioni nervoz, por nga kapilarët më të thellë të shpirtit, Dritëroi më zgjati dorën dhe e dëgjova të thoshte: "Jo, jo. Zijai ka të drejtë".

Në majë të gjuhës më vjen tash-ti diçka. Por po përmbahem, për të thënë një tjetër. Esenë "I gjallë mes shpirttrash të vdekur" ("Koha Jonë", 14 tetor, 2017), botuar në postum të Dritëroit, e kam mbyllur me këto radhë: "Mik i dashut, na ndodh t'i shohim me sy djemtë e rinj, që në trupin e tyre shkruajnë me bojë gjithfarë shenjash. Por vjen një moshë, ajo e bilancit, kur gjaku i zemrës i shkruan vetë shenjat e saj. E po ta them pra, e kam aty tautazhin e pashlyshëm për ty".

2

Një ditë, mbasi kisha pësuar humbje të pakthyeshme në kompjuter, nisa ecejaket nëpër dhomë gjithë substrat hidhësie. Befas, u ndala para raftit të librave. Në gjendjen siç isha, për të gjetur njëfarë ngushëllimi, kërkova të harrohesha me ndonjë libër të sigurt. Zgjodha një nga kryeveprat e letërsisë botërore, pikërisht "Pallatin e Ëndrrave". Për çudi, gjatë rileximit po ndihesa tepër luçid, çka ma shtonte sensin e depërtimit dhe të vetinterpretimit.

E solli rasti që mbas do kohe u ftova për kafe. Nuk ishte mëngjes, por muzg. As nuk ishim në Kafe Rostand, por në oborrin e "Pjacës". Kadareja, Helena, unë dhe Bujar Hudhri, botuesi i "Onufrit". Ra fjala e tregova për humbjen që kisha pësuar, rileximin e "Pallatit", si dhe... Kam dëgjuar kolegë që thonë se "me Ismailin nuk mund të bisedohet". Nuk po ndalem as të ndrydhetja e ndokujt, as të hasretet e forta si të xhenemit, as të xhindët e Kadaresë. Pse? Ngaqë përvojën e kam ndryshe, çka nuk do të thotë se po tipizoj marrëdhëniet e kurruktit. Unë jam mësuar që, nëse kam qenë kundër për diçka, ia



Helena dhe Ismail Kadare

kam thënë gjithmonë hapur, sy më sy, madje ka ndodhur edhe me dëshmitarë. Aq sa ndonjëherë miqtë e pranishëm më kanë rënë lehtë me gju nën tavolinë, si për të më tërhequr vëmendjen, kujdes, ç'po thua?! Për shembull, në sallën e Lidhjes me dëshmitar Ndoc Gjetjen, në shtëpinë e Ismailit me dëshmitar Visar Zhitin.

Veçse mos nxitoni, zotërinj, parimi im është duke u dashur, duke u dashur edhe kur mendojmë ndryshe! Ismailin e kam lexuar herët dhe jam shprehur qysh herët për krijimtarinë e tij. Po kujtoj vetëm një rast. Njëherë, duke synuar të shpjegjoja çelësin se si duhet lexuar vepra e Kadaresë, në një ese bëja referime me autorë perëndimorë, që atëherë mallkohehin me të madhe te ne. Në shkrimin e botuar në "MAPO" (21 shkurt 2015), Arben Kallamata e sjell kështu jehonën e asaj eseje: "Duhet të ketë qenë në vitin 1987 ajo paradite kur, për herë të parë, më ra në dorë romani "1984" i Orwell-it... Unë kujtoja se në redaksinë e atëherëshme të "Dritës" vetëm unë dhe Rudolfi (Marku) e kishim lexuar Orwellin. Por ja ku na del kryeredaktori, Zija Çela, që me një guxim prej të marri ia vesh drejt e në faqet e gazetës, duke krahasuar veprën e Kadaresë me atë të Orwell-it dhe të Prustit. Madje, për



E solli rasti që mbas do kohe u ftova për kafe.

Nuk ishte mëngjes, por muzg. As nuk ishim në kafe "Rostand", por në oborrin e "Pjacës". Kadareja, Helena, unë dhe Bujar Hudhri, botuesi i "Onufrit". Ra fjala e tregova për humbjen që kisha pësuar, rileximin e "Pallatit", si dhe...

Kam dëgjuar kolegë që thonë se "me Ismailin nuk mund të bisedohet".

dalë nga gjendja e mërzisë dhe tërheqjen nga rafti të "Pallatit të Ëndrrave". Mirëpo unë nuk mund t'i shmangesha atij luçiditetit të çuditshëm gjatë leximit, sidomos sensit të depërtimit dhe vetinterpretimit. Kujdes, m'u bë sikur po dëgjoja zërin e ndonjë miku, çfarë po matesh të thuash, ti vetë sapo e cilësive kryevepër dhe si kryevepër pranohet gjerësisht!

Megjithatë, iu drejtova Ismailit:

"Për mendimin tim, romani nuk duhet të këputet ashtu, pra të përfundojë në shtëpinë e Qypërlinjve. Ai ka nevojë për një pjesë më vete, vazhduese, pavarësisht se sa rreshta mund të jetë, mjaft që në mëngjes nëpunësi të kthehet sërish në institucionin e tij shtetëror, në Pallatin e Ëndrrave. Ky roman kaq polivalent dhe me fund krejt të hapur, do të më dukej me vend sikur nga ana kompozicionale të ishte i mbyllur, dhe të mbyllet tamam në pikën nga është nisur rrethi...".

Pas pak, Ismaili nxori një copë letër dhe diç po shënonte. Pastaj u ngrit dhe nisi të bënte vajtje-ardhje ndanë tavolinës.

"E di çfarë po bluan?", tha Bujari. "Po bluan atë propozimin tënd".

Helena buzëqeshte. Edhe në buzëqeshja, ngaqë edhe më vinte, edhe nuk më vinte ta besoja.

Në bibliotekën e shtëpisë e kam gjithë kompletin e Veprave të Ismailit. Madje për romanin "Darka e gabuar" kam aty edhe parathënien. Por "Pallatin" s'e kam shfletuar më asnjëherë. Nuk di pse, nuk dua ta shoh fundin, megjithëse ndokush thotë sikur ka shtuar diçka... Por kjo nuk është e rëndësishme, në superkrijimtarinë e përbotshme ka disa ëndrra të mistershme, që patjetër do të prisheshin, po të mos mbesin ëndrra. Prandaj rëndësi ka pohimi, ai pohimi që tashmë më ka ardhur në majë të gjuhës dhe nuk ka përse ta mbaj ende, përdërisa u bë nxitje për këto rrëfime. Shkrimtarët e mëdhenj nuk kanë vetëm gojë, as vetëm huj, inate shafitëse dhe zemëra të hatashme. Shkrimtarët e mëdhenj kanë edhe veshë.

Veçse, sipas një legjende të vjetër urbane, thonë se hapësira e lirisë së dialogut varet nga tjetri përballë dhe nga ç'zemër u flitet.



herë të parë publikisht në Shqipëri, Çela kishte shprehur edhe opinionin se Kadareja do të ishte i nderuar me Çmimin Nobel, po aq sa Nobeli me Kadarenë. Më rëndshëm nuk kishte si t'ua "këpuste" atyre kuteve të rrepta zyrtare. Reagimi ishte i menjëherëshëm dhe mjaft i fortë... Pa gjëma, e hodha me një Vërejtje me paralajmërim për përjashtim nga puna. Mirëpo njeriu i shkretë reglet me kohë. Unë do të merrja një tri-katër herë vërejtje të tilla, të cilat, nëse nuk përsëritej "proçka" brenda gjashtë muajve, të hiqeshin nga... Nga hiqeshin? Se ku drejtin shënosheshin dhe nga djallin hiqeshin nuk e di.

Por le të kthehemi te "Pjaca" kur i ftuar për kafe, rrëfeva humbjen në kompjuter, nevojën për të

Policia greke: Nga fillimi i vitit sekuestruan 204 kg marijuanë

Goditet grupi i trafikut të drogës Shqipëri-Greqi

Gjashtë të arrestuar në Selanik me 93 kg hashash

Sekuestrohen 93 kg marijuanë në Greqi, ndërsa pas kontrolleve të kryera, përfunduan në pranga 3 shqiptarë dhe 3 grekë. Gjashtë të arrestuarit rezultojnë pjesëtarë të një grupi të trafikut të drogës Shqipëri-Greqi. Dy prej shqiptarëve të moshës 31 dhe 52 vjeç kishin rol trafikimin e drogës nga Shqipëria në Greqi dhe më pas e transportin drejt Selanikut, ku ia dorëzonin pjesës tjetër të grupit. Policia ka ndërhyrë në Selanik gjatë shkëmbimit të një sasi droge ku janë pikasur 5 nga trafikantët. U arritën të kapeshin 3 prej tyre, dy shqiptarë të moshës 31, 52 dhe një grek 51 vjeç. Dy grekë të tjerë 35 dhe 64 vjeç u larguan me makinë, por u kapën më vonë në rrugën kombëtare Selanik-Moudiana. Gjatë operacionit u gjetën dhe u sekuestruan 52 kg e 728 gramë marijuanë dhe 1150 euro. Më pas u ushtrua kontroll në një banesë në Selanik, ku u gjet edhe një sasi tjetër droge prej 40 kg 225 gramë marijuanë, 2220 euro dhe 1 peshore. Për këtë u arrestua edhe një shqiptar tjetër 31-vjeçar. Në total u sekuestruan edhe 3 automjete. Prej fillimit të vitit, policia greke ka sekuestruar rreth 204 kg marijuanë që vinte nga Shqipëria.



ARRESTIMET

Përfunduan në pranga 3 shqiptarë dhe 3 grekë. Gjashtë të arrestuarit rezultojnë pjesëtarë të një grupi të trafikut të drogës Shqipëri-Greqi. Dy prej shqiptarëve të moshës 31 dhe 52 vjeç kishin rol trafikimin e drogës nga Shqipëria në Greqi dhe më pas e transportin drejt Selanikut, ku ia dorëzonin pjesës tjetër të grupit.

TE ARRESTUARIT

- Sh. P., 27 vjeç, për veprën penale "Përndjekje". Ky shtetas në rrugën "Dritan Hoxha" ka përndjekur ish-të dashurën.
- B. N., 21 vjeç, për veprën penale "Vjedhja". Ky shtetas në rrugën "Vangjel Noti" ka vjedhur një sasi lekësh në një mjet.
- M. J., 44 vjeç, për veprat penale "Dhunë në familje" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak". Ky shtetas ka ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike ndaj bashkëshortes. Gjatë kontrollit në banesë iu gjetën dhe dy armë zjarri "pistoleta".
- D. A., 38 vjeç, për veprën penale: "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak". Në rrugën "Ramazan Gaxherri" është ndaluar mjeti që e drejtonte ky shtetas. Gjatë kontrollit fizik i është gjetur një armë zjarri pistoletë.
- F. K., 44 vjeç, për veprën penale "Përndjekja". Ky shtetas në mënyrë të vazhdueshme ka përndjekur ish-bashkëshorten.
- E. H., 32 vjeç dhe E. P., 32 vjeç, për veprën penale "Vjedhja e kryer në bashkëpunim". Këta shtetas në Vorë, në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë vjedhur banesën e një shtetasi. Nga veprimet e kryera dyshohet se janë autorë edhe të katër vjedhjeve të tjera banesash të ndodhura në Vorë.

Nga përndjekja te dhuna në familje, kush janë të arrestuarit në Tiranë

Nga përndjekja te dhuna në familje e vjedhja. Këto janë disa nga akuzat për 7 persona të arrestuar nga policia e Tiranës për vepra të ndryshme. Gjatë aksionit në 24 orët e fundit u sekuestruan edhe 3 armë zjarri. Sipas policisë, arrestimet vijnë në kuadër të masave të shtrara për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e paligjshmërisë. Materialet iu referuan për veprime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



Tentuan të vidhnin bankomatin, në pranga dy veta

Policia e Bulqizës ka parandaluar grabitjen e një bankomati të një filiali banke të nivelit të dytë, ndërsa ka arrestuar 2 autorët e dyshuar. Policia bën me dije se ka arrestuar shtetasin E.A., 31 vjeç dhe F.L., 35 vjeç, banues në Bulqizë (të dy të dënuar më parë për veprën penale të vjedhjes). "Këta dy shtetas në bashkëpunim me njëri-tjetrin në orët e para të mëngjesit të datës 26.01.2019, të maskuar dhe me sende të forta tentuan të vidhnin bankomatin e filialit të një banke të nivelit të dytë në 'Lagjen e



Re' Bulqizë", - thuhet ndër të tjera në njoftimin e policisë. Materialet hetimore i kaluan Prokurorisë Dibër për veprën penale "Vjedhje e

bankave dhe arkave të kuresimit", kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 136/2 e 25 22 të Kodit Penal.

Arrestohen në Maqedoni 9 striptiste nga Shqipëria

Gjatë një aksioni policor prej orës 22:00 të natës së mbrëmshme deri në orën 04:00 të mëngjesit të së dielës janë arrestuar 26 femra të moshës prej 20 deri në 46 vjeç në 5 hotele në Tetovë dhe Gostivar. Siç kanë informuar nga MPB, gjatë kontrollit në hotele janë gjetur 39 femra, prej të cilave 13 nga Maqedonia, ndërsa 26 kanë qenë të huaja. 11 prej tyre janë nga Serbia, 9 nga Shqipëria, 4 nga Bullgaria dhe nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova.





KESHILLA



ISHP:
Mënyrat e
trajtimit të kancerit
në qafën e mitrës

KESHILLA



Si të parandaloni
sulmet në zemër dhe
infarktin, medikamentet që
duhet të përdorni

YLLI MERJA:

Mjeku popullor:
Fazat e sëmundjes
dhe simptomat
kryesore që nuk
duhen neglizhuar



Si të kuroni sinusitin nëpërmjet mjekësisë alternative

"Përdorni kungullin e
egër dhe propolisin e bletës"

Ushqimet që duhet të konsumoni për të rifituar energjinë

Voltiza Duro

Sezoni i dimrit vjen me surpriza jo të këndshme, duke na sjellë jo vetëm gripin, por edhe sinusitin. Në periudhat e ftohta sinusiti fillon të shfaqet, sidomos pas një gripi të gjatë. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku popullor Ylli Merja tregon simptomat kryesore të sëmundjes, të cilat nuk duhen neglizhuar, për të parandaluar kështu në kohë përkeqësimin e saj. Më tej, mjeku thekson se nëse nuk trajtohet në kohë, sinusiti mund të çojë deri në shfaqjen e migrenës. Sipas Merjas, përdorimi i kungullit të egër dhe propolisit të bletës janë një kombinim perfekt për të kuruar sëmundjen nëpërmjet mjekësisë alternative.

Si fillon sinusiti dhe cilat janë moshat më të prekura?

Sinusiti shfaqet në moshë të ndryshme, duke filluar që nga fëmijë deri tek të moshuarit. Mund të shfaqet pas një gripi, pas një infeksioni i cili kalon në hundë dhe zhvillohet aty më tej psh., Stafilokoku apo Streptokoku. Shumë individë e ngatërrojnë dhimbjen e kokës që vjen nga sinusiti me dhimbjen e kokës të migrenës apo me dhimbjen e kokës nga dehidratimi.

Si mund ta dallojmë që kemi sinusit?

Sinusiti shkakton dhimbje të kokës në pjesën e përparme të saj. Kjo dhimbje fillon të shfaqet kur ne sapo na ka prekur një grip, apo një virozë dhe kemi rrjedhje të hundëve. Pas 3-6 ditësh një virozë e lehtë kalon, nëse akoma vazhdoni të keni rrjedhje të hundëve të vazhdueshme do të thotë se jeni në hapat e para të sinusitit, faza numër 1. Sinusiti në këtë fazë është i lehtë dhe mund të kalojë shumë shpejtë në kushte shtëpie.

Po në fazën e dytë të sëmundjes, cilat janë shqetësimet që shfaqin pacientët?

Pas kësaj faze rrjedhja e hundëve bëhet nga shumë e shpeshtë në më të rrallë gjatë ditës dhe rrjedhjet janë më viskoze. Këtu fillon faza e dytë kur rrjedhjen fillojnë të bllokohen në sinuse. Kjo fazë është më e vështirë për t'u kuruar, pasi infeksioni është i bllokuar dhe fillon të shtohet. Në këtë moment fillojnë dhimbjet e kokës shumë të forta dhe personi është i rritur mendon se kjo dhimbje shkaktohet nga migrena. Është e vërtetë që nëse sinusiti nuk trajtohet në këtë fazë dhe infeksioni vazhdon të qëndrojë në brendësi të sinuseve, atëherë kjo shkon në migrenë në moshë madhore. Por, nëse kapet që në fillim atëherë nuk duhet të lihet pas dore. Të gjitha këto faza m'i kanë përshkruar individët të cilët kanë vuajtur nga sinusiti. Secili më ka dhënë përshkrimet e tyre dhe unë kam arritur në këtë përfundim duke i radhitur të gjitha fazat që kanë kaluar të gjithë personat që unë kam përballur për gjatë punës sime.

Cilat janë simptomat kryesore të sëmundjes?

Simptoma kryesore që sinjalizon sinusitin është dhimbja në zonën e ballit. Edhe nëse uleni për të kapur gishtat e këmbëve dhe keni këto ndjesi: ndjeni pulsime midis syve dhe në zonën e ballit dhe presion në veshë dhe kur çoheni ndjeni marrje mendsh ose errësim të

Mjeku popullor: Fazat e sëmundjes dhe simptomat kryesore që nuk duhen neglizhuar

YLLI MERJA:

Si të kuroni sinusitin nëpërmjet mjekësisë alternative

"Përdorni kungullin e egër dhe propolisin e bletës"



Ylli Merja

syve, mund të jetë paralajmërim për sinusit. Nuk e duroi dot dritën, kjo është edhe një prej arsyeve pse sinusiti ngatërrohet me migrenën. Ju nuk e duroi dot dritën, sepse infeksioni që ndodhet në sinuse është rreth syve dhe kështu ju krijon ndjeshmëri më të lartë të syve. Edhe kur jemi të lodhur ne fillojmë të kemi gjumë dhe nuk duam drita shumë të forta kur përgatitemi për gjumë. Sytë ndihen të tensionuar duke qenë gjithë kohën nën presionin e shtypjes së infeksionit dhe kështu lodhen. Duhet t'i drejtoheni mjekut edhe kur keni vështirësi të flini pasi ndjeni presionin e sinuseve



kur shtriheni, sidomos në veshë, sy dhe mbi dhëmbët e sipërm. Si mund ta shërojmë sinusitin me bimë medicinale? Sinusiti është një sëmundje që sh-

kakton shumë probleme në jetën e përditshme dhe gjendjen tuaj fizike, pasi prek direkt kokën. Prandaj është e rëndësishme të merren masa të menjëhershme. Si fillim për të ndihmuar në pastrimin e sinuseve përdoret kungulli i egër. Ai ndihmon që t'i ngacmojë bakteret që ndodhen në sinuse dhe t'i bëjë që të dalin tërësisht. Kungulli i egër këshillohet të përdoret pasi e keni kaluar gripin dhe kur të ndiheni mirë fizikisht, pasi ju bën të ndiheni të këputur për 2 ditë e para pasi përdoret. Gjithashtu, kungulli i egër duhet përdorur shumë me kujdes, pasi është një bimë shumë e fortë dhe mund t'ju shkaktojë dëme në organizëm nëse nuk përdoret siç duhet. Kungulli është bima çudibërëse për sinusitin, por ai i humbet shumë vetitë e tij kur ekstrahohet. Bima më e fuqishme është bima e njomë, e cila është 100% e efektshme.

Mund të na tregoni si duhet përdorur kungulli për trajtimin e sëmundjes?

Merret një kokërr kungulli i egër, shtrydhet në një filxhan, hiqen tërësisht farat dhe copat e bimës. Tek lëngu i bimës shtohet pak sheqer dhe tretet me lëngun. Merrret një pipetë dhe transferohet lëngu në të. Më pas hidhni 2-3 pika në secilën anë të hundës. Mbajeni kokën vetëm 60 sekonda të përkulur mbrapa, mundohuni ta bllokoni lëngun te kalojë poshtë. Pas 60 sekondash, nxirreni lëngun nga hundët komplet. Në këtë moment konsumoni pak gjalpë, ose vaj ulliri dhe pastaj 10 pika propolis. Do të keni shumë testitje pasi e hidhni kungullin në hundë, skuqje të syve dhe shenja sikur jeni me grip. Por nuk duhet të shqetësoheni, pasi këto janë vetëm ndjesia që të krijon kungulli i egër. Dhe do të kaloni pas 2-3 ditësh së bashku me sinusitin. Kujdes! Kungulli nuk duhet të kalojë në asnjë mënyrë poshtë. Lani duart mirë pasi ta shtrydhi kungullin, ose mund të përdorni një dorezë.

Cilat janë këshillat tuaja për të gjithë të prekurit nga sinusiti? Pasi aplikoni kungullin e egër, 3 ditë e para duhet të konsumoni propolis blete, 4-5 herë në ditë për fëmijë dhe të rriturit sipas dozave përkatëse. Gjithashtu, duhet të bëni



avull vetëm në darkë, pasi ndihmon që të hapen porët dhe sinuset, por nëse dilni jashtë në ajër të ndotur, atëherë akoma më shumë baktere do të hyjnë në hundë e do të zhvillohen aty. Avulli mund të bëhet me çaj për sinusitin. Është një mikser çajrash që ndihmon në hapjen e sinuseve. Ka efekt antibakterial të fuqishëm, ndihmon në luftimin e stafilokokut e streptokokut. Propolisi i bletës duhet të përdoret 4-5 herë në ditë, për 3-4 ditë e para pasi përdorni kungullin. Më pas përdoret vetëm 3 herë në ditë.

Si mund të parandalohet sëmundja?

Nëse jeni duke kaluar një periudhë gripi përdorni çajra që ndihmojnë në rritjen e imunitetit dhe ushqime me vitaminë C, hidhni pika me ujë deti në hundë, bëni avull me çajin mikser për sinusit, si dhe përdorni aerosolet në dhomë dhe hidhni në to vajra esenciale si dafina apo ekujalipsi.



Kanceri i qafës së mitrës është një lloj kanceri, i cili zhvillohet në qafën e mitrës së një femre dhe është kanceri i dytë më i zakonshëm te femrat, veçanërisht në vendet në zhvillim. Instituti i Shëndetit Publik thekson se kanceri i qafës së mitrës është një sëmundje tërësisht e parandalueshme e megjithatë, ai mbetet shkak i rëndësishëm i vdekjes nga kanceri te gratë në mbarë botën. Më tej, ISHP jep një informacion të detajuar mbi shkaktarët e sëmundjes, simptomat dhe mënyrat e trajtimit të saj.

SHKAKTARËT


Kanceri i qafës së mitrës shkaktohet nga infeksioni i vazhdueshëm ose kronik me një ose më shumë lloje të virusit të papilomës humane-HPV, një infektion i zakonshëm i traktit riprodhues që transmetohet seksualisht. Ka shumë lloje të HPV-së, por jo të gjitha shkaktojnë probleme. Kryesisht llojet 16 e 18 të HPV-së, njihen si lloje me rrezik të lartë kancershaktues të kancerit të qafës së mitrës te gratë. Çdo grua mund të jetë në rrezik për kancer të qafës së mitrës, por një femër është më e rrezikuar për t'u prekur nëse: ka filluar herët marrëdhënien e parë seksuale, ka partnerë seksualë të shumtë, ka partnerë të cilët kanë apo kanë pasur shumë partnere seksuale, ka apo ka pasur një infektion seksualisht të transmetueshëm, përdor në mënyrë abuzive duhanin apo ka imunitet të ulët.

SIMPTOMAT

Shumica e infeksioneve nga HPV nuk kanë shenja dhe kalojnë në mënyrë spontane. Kur shfaqen shenjat mund të përfshijnë: gjakderdhje jo të rregullt midis cikleve menstruale, gjakderdhje jonormale vaginale pas marrëdhënieve seksuale, dhimbje mesi apo në fund të barkut, lodhje, humbje peshe dhe oreksi, parehati vaginale ose sekrecione vaginale jonormale, dhimbje gjatë kontaktit seksual etj. Në faza të avancuara shfaqen edhe simptoma të tjera më të rënda.

PARANDALIMI DHE DEPISTIMI

Pothuajse çdo rast me kancer të qafës së mitrës mund të parandalohet nëpërmjet depistimit/kontrollit dhe vaksinimit. Depistimi/kontrolli për kancerin e qafës së mitrës është testimi për të kapur fazat parakanceroze dhe kancerin te gratë, të cilat akoma nuk kanë simptoma dhe mund të ndihen të shëndetshme dhe gjithashtu kur trajtimi ka një mundësi të lartë për shërim. Aktualisht janë në dispozicion disa lloje testesh depistuese: Pap testi, kontrolli pamor me acid acetik/VIA, testimi për HPV me rrezik të lartë, si dhe kolposkopia. Pap testi është një test tradicional



ISHP: Mënyrat e trajtimit të kancerit në qafën e mitrës

depistues, i shpejtë, i thjeshtë, jo i dhimbshëm, zgjat vetëm pak minuta, por mund të shpëtojë jetën e një femre. Pap testi mund të kryhet ambulatorisht në një klinikë apo spital. Nëse rezultati i Pap testit është normal, rreziku për kancer të qafës së mitrës është i ulët. Nëse rezultati i Pap testit del jonormal, do të thotë që disa qeliza jonormale janë gjetur në qafën e mitrës, por kjo nuk do të thotë gjithmonë që janë kanceroze. Nëse Pap testi tregon një dyshim apo gjendje jonormale, mjeku kërkon të përsëritet testi mbas 6 muajsh apo kërkon të kryhen ekzaminime të tjera shtesë.

TESTI HPV

Testimi për HPV është metodë testimi që bazohet në zbulimin e ADN-së së HPV me rrezik të lartë në mostrat vaginale ose të qafës së mitrës. Në testimin për HPV, merret një mostër qelizash duke futur në vaginë një furçë të vogël. Mostra mund të mblihet dhe nga vetë gruaja duke e udhëzuar paraprakisht. Një test pozitiv HPV nuk konfirmon se gruaja ka parakancer; ai vetëm konfirmon se ka një infektion me HPV. Testimi për HPV rekomandohet për çdo grua duke filluar nga moshë 30 vjeç. Por, edhe pse kanceri i qafës së mitrës është i rrallë para moshës 30 vjeç, depistimi mund të bëhet dhe te gratë më të reja se 30 vjeç nëse vihet



rrezik i lartë. Organizata Botërore e Shëndetësisë rekomandon depistimin për çdo grua seksualisht aktive nga moshë 30 deri në 49 vjeç, të paktën një herë në jetë dhe në mënyrë ideale më shpesh. Vaksinimi kundër HPV-së redukton në masë të konsiderueshme rrezikun për kancer të qafës së mitrës. Aktualisht në dispozicion janë disa lloje vaksinash që sigurojnë një mbrojtje të lartë kryesisht kundër llojeve kancershaktuese të HPV. Studimet tregojnë se vaksinat janë të sigurta dhe shumë efektive në parandalimin e infeksionit me HPV nëse aplikohen para ekspozimit të

HPV-së. Prandaj preferohet që ato të aplikohen para aktivitetit të parë seksual. OBSH rekomandon vaksinimin për vajzat e moshës 9-13 vjeç. Ndërhyrje të tjera parandaluese përveç depistimit dhe vaksinimit, të rekomanduara nga OBSH si për djemtë dhe për vajzat janë: edukimi lidhur me praktikën e sigurta seksuale e fillimi me vonesë i aktivitetit seksual, promovimi i përdorimit të prezervativit për ata që kryejnë aktivitet seksual; paralizimi i përdorimit të duhanit dhe rrethprerja mashkullore (syneti). Edukimi shëndetësor siguron që gratë, familjet e tyre e komuniteti

në përgjithësi të kuptojnë se kanceri i qafës së mitrës është i parandalueshëm.

TRAJTIMI

Depistimi në vetvete nuk ka asnjë vlerë parandaluese nëse nuk lidhet me trajtimin e rasteve parakanceroze të qafës së mitrës. Nëse kanceri i qafës së mitrës kapet herët, është më i lehtë për t'u trajtuar, mbijetesa rritet dhe cilësia e jetës së gruas është më e mirë. Në disa raste, pjesët jonormale duhen hequr që të mos përparojnë në kancer të qafës së mitrës. Kjo gjë kërkon një trajtim të thjeshtë dhe jo gjithmonë kërkon shtrimit në spital. Ky trajtim nuk ndikon në jetën seksuale apo në mundësinë për të pasur fëmijë në të ardhmen. Gratë që janë trajtuar për parakancer të qafës së mitrës duhet të ndiqen dhe trajtohen pas 12 muajsh. Nëse më pas shenjat e kancerit të qafës së mitrës janë të pranishme, mundësitë e trajtimit përfshijnë kirurgjinë, radioterapinë dhe kimioterapinë. Nëse kanceri i qafës së mitrës kapet herët, është më i lehtë për t'u trajtuar, mbijetesa rritet dhe cilësia e jetës së gruas është më e mirë.

Jo pak persona në ditët e sotme shfaqin shqetësime me rrahjet e zemrës, çka rrit mundësinë për formim trombesh e si pasojë edhe për të kaluar infarkt. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjekja patologe, Vlera Lekaj tregon disa prej trajtimeve që duhet të përdorin pacientët që kanë çrregullime të tilla, me qëllim shpëtimin e jetës. Më tej, mjekja thekson se në mënyrë absolute nuk mund të ndërpritet medikamenti pa sugjerimin apo këshillën e mjekut. Gjithashtu, Lekaj shton se Warfarina është një tjetër antikoagulant i rëndësishëm në praktikën klinike për të mbrojtur nga formimi i trombeve. Ky medikament inhibon veprimin e enzimave që përdorin vitaminën K për prodhimin e faktorëve të koagulimit, duke ndërrhyrë kështu në procesin e koagulimit dhe si pasojë duke e zgjatur atë. Antikoagulantët përfaqësojnë një klasë të rëndësishme medikamentozë, e cila shërben për një mision thelbësor në ndalimin e formimit të trombeve në qarkullimin e gjakut. Një nga emrat më të rinj në treg dhe më të lakuar është dhe Rivaroxaban, i njohur ndryshe si Xarelto. Rivaroxaban përfshihet në atë grup antikoagulantësh të quajtur inhibitorë të faktorit Xa të koagulimit. Nëpërmjet inhibimit të këtij faktori të rëndësishëm në procesin e koagulimit të gjakut, ky lloj antikoagulantit ul drejtpërdrejtë në këtë mënyrë aftësinë koagulative të gjakut. Përdorimi i tij është kryesisht i përqendruar për rastet e trajtimit të trombozave venoze si dhe embolive pulmonare, si dhe ka një funksion të rëndësishëm parandalues të infarktit akut në pacientët, të cilët vuajnë nga fibrilacioni atrial. Te këta pacientë si pasojë e rrahjeve të çrregullta të zemrës, rritet mundësia për formim trombesh dhe si pasojë për të kaluar infarkt. Doza ditore e këtij medikamenti varion në 2 herë në ditë për 21 ditë në rastet e trajtimit të trombozave venoze dhe embolive pulmonare dhe më pas kalon në një doze të vetme ditore. Si dhe në rastet e



parandalimit të infarkteve në pacientët me fibrilacion atrial përdoret një dozë e vetme ditore me vaktin e darkës. Marrja e Rivaroxaban duhet të jetë e rregullt dhe në të njëjtin orar të ditës, duke ndjekur këshillat e dhëna nga mjeku. Një vëmendje e veçantë u këshillohet pacientëve nga mjekët për mosndërprerjen në mënyrë absolute të këtij medikamenti pa sugjerimin apo këshillën e mjekut. Medikamenti duhet të vazhdohet edhe nëse ndjeheni mirë si dhe në rast ndërprerjeje të Rivaroxaban për një arsye ose tjetër, siç mund të jetë një efekt anësor i mundshëm i tij me epistaksis (hemorragji nga hunda) apo një vend tjetër hemorragjie, atëherë duhet të zëvendëso-


het me një antikoagulant tjetër. Te mjeku i familjes diagnoza e fibrilacionit atrial është ndër më të shpeshtat dhe përfaqëson një nga sëmundjet kronike me incidencë të lartë në popullatë, ku më të prekurrit janë moshën e mesme dhe të moshuar. Ndërsa marrja e Rivaroxaban është e indikuar vetëm në rastet të rrezikshme, sigurisht tek pacientët të cilët krahas diagnozës bazë, kanë edhe sëmundje të tjera shoqëruese si insuficiencë cardiace, diabet mellitus, ishemi cerebrale është një kuadër alarmues që kërkon ndërhyrjen me këtë medikament të fuqishëm në parandalimin e formimit të trombeve. Përpara se të prezantoj një studim të kohëve të fundit që tregon epër-

inë e Xarelto në raport me antikoagulantët e tjerë, do të flas pak për barin Warfarine. Warfarina është një tjetër antikoagulant i rëndësishëm në praktikën klinike për të mbrojtur nga formimi i trombeve. Warfarina inhibon veprimin e enzimave që përdorin vitaminën K për prodhimin e faktorëve të koagulimit, duke ndërrhyrë kështu në procesin e koagulimit dhe si pasojë, duke e zgjatur atë. Në studimin retrospektiv në popullatë reale krahasohej incidencën e hemorragjive gastro-intestinale në pacientët e trajtuar me antikoagulantë që nuk janë antagonist të vitaminës K dhe Warfarinës. Ku në rastin e parë u regjistruan vetëm 5 pacientë me hemorragji madhore, ndërsa në rastin e

Antikoagulantët përfaqësojnë një klasë të rëndësishme medikamentozë, e cila shërben për një mision thelbësor në ndalimin e formimit të trombeve në qarkullimin e gjakut. Një nga emrat më të rinj në treg dhe më të lakuar është dhe Rivaroxaban, i njohur ndryshe si Xarelto.

dytë u regjistruan 158 raste. Si dhe gjatë hospitalizimit 90-ditor të pacientëve, 12 pacientë në grupin e Warfarinës vdiqën dhe 2 pësuan trombozë të venave të thella, ndërsa në grupin e antikoagulantëve jo antagonist të vitaminës K nuk pati asnjë rast vdekje, aksidente cerebro-vaskulare, apo tromboza të venave të thella. Studimi tregon ndjeshëm epërsinë e antikoagulantëve jo antagonist të vitaminës K, ku Xarelto është një nga përfaqësuesit e këtij grupi. Sigurisht është një nga zhvillimet më të mëdha në mjekësi dhe në farmaceutikë dalja në treg e një medikamenti të tillë. Një medikament me efekte anësore të rralla, i cili parandalon rrezikun e infarktit të të sëmurrët me fibrilacion atrial, duke shpëtuar çdo ditë një jetë.

Si të parandaloni sulmet në zemër dhe infarkt, medikamentet që duhet të përdorni



Këshilla



Këshilla efektive për një buzëqeshje të shndritshme

Një buzëqeshje e bardhë dhe e shndritshme është "aksesori" më i mirë që mund të vendosim, por ndonjëherë dhëmbët ndryshojnë ngjyrë e bëhen të verdhë, duke krijuar një shqetësim estetik e jo vetëm për shumë prej nesh. Por çdo gjë e ka një zgjidhje, por para se t'i drejtoheni dentistit, më poshtë mund të gjeni disa këshilla për zbardhjen e dhëmbëve në kushte shtëpie. Përpos pastave, furçave të dhëmbëve dhe lëngjeve dezinfektuese të gojës, për të pasur dhëmbë përsosmërisht të bardhë në mënyrë natyrale duhen ndjekur disa këshilla për tryezën e ushqimeve.

Soda e bukës

Soda e bukës, e pranishme në kuzhinën tonë ndihmon në largimin e pllakave të krijuara tek dhëmbët, të cilat shkaktojnë ngjyrën e verdhë.

- Mund të përzieni gjysmë luge çaji me sodë buke. Me këtë masë lani dhëmbët me furçë e me ujë të ngrohtë, tamam si me pastë dhëmbësh normale. Përsëriteni këtë ritual 2 herë në javë.
- Ose mund ta përzieni atë me lëng limoni, utull molle



ose peroksid hidrogjeni.

- Gjithashtu mund të përzieni një lugë sodë buke me një tjetër me peroksid hidrogjeni. Masën e hidhni në një gotë me ujë të ftohtë dhe me të shpëlani gojën 2-3 herë në ditë.

Lëkurë portokalli

Pastrimi i rregullt i dhëmbëve me lëkurë të freskët portokalli redukon akumulimin e papastërtive.

- Para se të flini, merrni pak lëkurë portokalli dhe me të fërkoni dhëmbët tuaj. Vitamina C dhe kalciumi që ajo përmban do të luftojë mikroorganizmat përgjatë natës.

- Përsëriteni për disa javë dhe shikoni rezultatet.

Peroksid hidrogjeni

Efektet e peroksidit të hidrogjenit janë dhëmbë të bardhë si perlë, përsëri.

- Bëni gargarë me këtë lëndë, por sigurohuni që mos ta përcillni.
- Gjithashtu mund të krijoni një masë me peroksid hidrogjeni së bashku me sodë buke, të cilën mund

ta përdorni si pastë dhëmbësh. Me vonë lajini dhëmbët me një pastë normale. Përdorimi i tepërt i peroksidit të hidrogjenit mund të krijojë irritim të mishrave të dhëmbëve, kështu që ju rekomandojmë që të mos abuzoni.

Limon

Vitamina C dhe acidet që limoni përmban janë shumë të përshtatshëm për të larguar pllakëzat nga dhëmbët tuaj. Mund ti përdorni lëngun, por edhe direkt lëkurën e tij.

- Përzieni pak lëng limoni me kripë.

- Aplikojeni atë tek dhëmbët e zverdhur dhe e lini për pak minuta. Më pas shpëlajeni gojën me ujë të ngrohtë.

- Përsëriteni dy herë në ditë për dy javë për rezultate më të mira.

Kripë

Kripa është një prej agentëve pastrues më të rëndësishëm dentar përdorur prej dekadash. Ajo ndihmon në rikuperimin e mineraleve të humbura prej dhëmbëve dhe rigjenerimin e ngjyrës së bardhë të tyre.

- Mund ta përdorni në vend të pastës së dhëmbëve çdo mëngjes e më vonë ta shpëlani.
- Ose mund ta përzieni me sodë buke e lehtë të fërkoni dhëmbët.



Ushqimet që duhet të konsumoni për të rifituar energjinë

Të gjithë kemi ditë kur ndihemi jash-tëzakonisht të lodhur dhe të përgjumur dhe kuptojmë se as 4 filxhanë me kafë nuk mund të na bëjnë gjë. Por energjinë mund ta fitoni nëpërmjet karbohidrateve, sepse ato janë të përbëra nga glukozja që është burimi kryesor i trupit për energji. Më poshtë do të gjeni disa kombinime ushqimesh që do u japin energji të renditura nga "Health Magazine".

MOLLË DHE GJALPË KIKIRIKU Është kombinimi perfekt, sepse është ushqim i shëndetshëm dhe jep shumë energji.

Kos grek dhe fruta pylli
Kosi grek është i pasur në proteina dhe mund ta shoqëroni me fruta pylli që kanë shumë fibra dhe ndihmojnë në tretjen e ushqimit.

NJË GJYSMË TASI ME FRUTA TË THATA
Duke qenë se frutat e thata kanë shumë kalori, duhet të konsumoni gjysmë tasi për të marrë energji.

DJATHË KAÇKAVALL DHE DARDHË
Dardhët kanë shumë sheqer, por janë të pasura në fibra. Për të fituar energji duhet të konsumoni dardhët me djathë kaçkavall që ka sasi të ulët yndyre.

KOKOSHKAT PA YNDYRË
Kokoshkat kanë shumë karbohidrate në përbërje dhe fibra që rrisin nivelin e energjisë. Mund të shtoni dhe pak kikirikë të copëtuar.

Tjetër protestë masive kundër presidentit serb

Aleksandar Vuçiç pyet serbët: Çfarë çmimi mund të paguajmë për Kosovën?

Serbia e qytetarëve, "Vuçiç në burg". Kjo është porosia që mijëra qytetarë serbë i kanë çuar Presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiç. Kanë dalë sërish në rrugë të rrethuar nga dëborë dhe acari i temperaturave nën minus. Këtë protestë e kanë mbështetur një grup i akademikëve dhe profesorëve universitar. Ata e quajnë Vuçiç një diktator. "Nuk guxojmë të heshtim. Duhet t'u bashkohemi qytetarëve. Ky është një pushtues dhe në këtë shtet ka ndaluar mundësinë e demokracisë, ka ndaluar drejtësinë, ndarjen e push-

tetit, sistemin shumëpartiak dhe mediat e lira e profesionale", thotë një profesor. "E vetmja mënyrë për të kthyer këtu rendin, ligjin dhe Kustetutën është largimi i Vuçiç nga pushteti", shprehet një gjykatës. Protestuesit thonë se Vuçiç ka futur nën kontroll shumicën e mediave dhe shoqërinë. Tek gazeta më e vjetër, "Politika", i mbyllën derën me mbishkrimet e censuruara dhe më pas vazhduan para televizionit publik që, siç thonë, asnjëherë nuk

fton opozitën. Para qeverisë e akuzuan për marrëveshje të fshehta me Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Nga ana tjetër presidenti serb, Aleksandar Vuçiç ka thënë se është koha që të fillohet të mendohet për njerëzit, duke mbrojtur interesat e tyre dhe për të fituar sa më shumë të jetë e mundur, por shtoi se mashtrohet kushdo që mendon se është e mundur të mbahet konflikti i ngjirë në Kosovë. "Jam i dëshpëruar në qoftë se njerëzit nuk duan

ta kuptojnë, por unë këtë nuk mund ta ndryshoj, siç nuk do ta ndryshoj politikën që është racionale, serioze dhe e përgjegjshme dhe që po sjell rezultate të mira për Serbinë", ka thënë Vuçiç. Siç raportojnë mediat serbe, Vuçiç iu përgjigj pyetjeve të gazetarëve se cili është kompromisi ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, që do të jetë i pranueshëm në Gjermani, cila vlerëson përpjekjen tonë për të arritur një kompromis dhe e cila e ka njohur tash-



më Kosovën brenda kufijve ekzistues. Vuçiç rikujtoi se jo vetëm Gjermania, por 27 vendet anëtare të BE-së tashmë e kanë njohur pavarësinë e Kosovës brenda kufijve të saj, përcjell "Telegrafi". "Ndonjëherë rrallë e kujtojmë këtë, sepse nganjëherë do të harronim edhe për botën, pastaj 20 minuta më vonë do të jem pjesë e botës dhe shpesh po largohemi nga realiteti. Unë besoj se Gjermania do të përkujdeset jo vetëm për dialog, por edhe për arrijtjen e një zgjidhjeje kompromisi. A do të kemi sukses? Mbetet të shihet", tha ai.

Ramush Haradinaj: Pa marrëveshje politike me Serbinë, nuk hiqet tarifa

Vijon presioni i SHBA-ve ndaj Prishtinës zyrtare që ta heqë taksën ndaj prodhimeve të Serbisë, në mënyrë që t'i hapet rrugë dialogut. Por qeveria e Kosovës aktualisht nuk ka plane për heqjen e taksës. Kësaj radhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës u shprehën të prera në qëndrimin e tyre drejtuar qeverisë së Kosovës përsa i përket taksës ndaj Serbisë. "Pezullojeni menjëherë taksën ndaj prodhimeve të Serbisë dhe Bosnje-Hercegovinës, ose përballuni me pasojat". Në një komunikatë për media, të lëshuar nga Ambasada e SHBA-ve thuhet se procesi i bisedimeve Kosovë-Serbi i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian duhet rifilluar, ndërsa pengesat që vijnë për këtë proces janë kundër interesave të SHBA-ve. "Një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe me dobishmëri të ndërsjellë është në interesin strategjik të Shteteve të Bashkuara. Thërrasim biseduesit nga Kosova dhe tjerët nga rajoni që të tregojnë përkushtim ndaj normalizimit, paqes e stabilitetit rajonal dhe ndaj lëvizjes nëpër shtegun drejt integritimit evropian. Ne ritheksojmë pikëpamjen tonë se një pezullim i menjëhershëm i tarifës në importet nga Serbia dhe Bosnja është një masë e nevojshme për të rimëkëmbur procesin e dialogut. Presim edhe nga biseduesit e tjerë të ndërmarrin masat e tyre konstruktive", thuhet në komunikatën e Ambasadës së SHBA-ve, duke tërhequr vëmendjen që mos të punohet kundër interesave të SHBA-ve. "Kosova apo cilido mik tjetër i Shteteve të Bashkuara nuk mund të ndërmarë veprime që janë kundër interesave tona strategjike, pa u ballafaquar me pasojat për marrëdhëniet tonë bilaterale", thuhet me tej në komunikatë, duke kërkuar nga udhëheqësit politikë të Kosovës që të tregojnë lidhësi. "E nevojshme tani është një lidhësi i guximshëm për të promovuar qëllimet tona të

SHBA, ultimatum Kosovës: Hiqni taksën, ose përballuni me pasojat!

Avdullah Hoti: Këmbëngulja e qeverisë është e kotë



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj

RAMUSH HARADINAJ

"Ne jemi të hapur, pra jemi të interesuar për pezullimin e taksës, nëse ka gatishmëri për t'u rregulluar marrëdhëniet politike Kosovë-Serbi, që nënkupton edhe njohjen e Kosovës", ka thënë Ramush Haradinaj.

përbashkëta. Kjo është ajo që na ndihmon në për të mbajtur një marrëdhënie të fortë bilaterale, përfundon komunikata e Ambasadës së SHBA-ve. Por, aktualisht qeveria e Kosovës duket nuk e ka ndërmend ta heqë taksën ndaj prodhimeve të Serbisë dhe Bosnje-Hercegovinës. Kryeministri Ramush Haradinaj thotë se, "pa një marrëveshje politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, taksat nuk hiqet. Ne kemi hyrë në disa dimensionet e reja në politikë në Kosovë, do të thotë këtë vit

shumicën e kohës do ia kushtojmë ekonomisë. Marrëdhëniet ekonomike Kosovë-Serbi janë të rëndësishme, ndonjëherë do të rregullohen, pra pa një marrëveshje politike Kosovë-Serbi është zor të mbajmë të rregulluara marrëdhëniet e tjera. Ne jemi të hapur, pra jemi të interesuar për ta pezulluar taksën, nëse ka gatishmëri për t'u rregulluar marrëdhëniet Kosovë-Serbi politike, e që nënkupton edhe njohjen e Kosovës pra", ka thënë Ramush Haradinaj. Para se të publikohet dek-

larata e ambasadës së SHBA-ve, kryeministri Ramush Haradinaj ishte edhe më shumë i prerë në qëndrimin e tij për mosheqje të taksës ndaj prodhimeve të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, duke thënë se, "për shkak të letërës së presidentit Trump dërguar në Kosovë, Kosova ka hequr dorë nga masat e mëtejshme të parapara ndaj Serbisë". "Nuk e kemi në plan të mos e respektojmë letëren e presidentit Trump, pra ne kemi ndalë në veprime që kanë qenë të planifikuara, në respekt pikërisht të aleatit tonë, Amerikës, e letërës së presidentit Trump, t'i japim një mundësi procesit. Ne e shohim që Serbia nuk është ndalur, ajo po e rrit agresivitetin e vet dhe duhet ta vlerësojmë një herë se si të veprohet me tutje", tha kryeministri Haradinaj, duke shtuar se "tarifa për mallrat serbe do të vazhdojë

ULTIMATUMI I SHBA-ve
"Pezullojeni menjëherë taksën ndaj prodhimeve të Serbisë dhe Bosnje-Hercegovinës, ose përballuni me pasojat! Një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe me dobishmëri të ndërsjellë është në interesin strategjik të Shteteve të Bashkuara", thuhet në komunikatën e Ambasadës së SHBA-ve.


sosë një nga një me greva, aq më shumë qeveria insiston në taksën prej 100 për qind. Përveç taksës, kjo qeveri nuk ka asgjë tjetër për t'iu ofruar qytetarëve", tha Avdullah Hoti. Nga ana tjetër, autoritetet e Serbisë vazhdojnë të mbajnë qëndrimin e tyre se pa heqjen e taksës nga Kosova ndaj prodhimeve të tyre, nuk e fillojnë dialogun me Kosovën. Presidenti serb, Aleksandar Vuçiç, ka deklaruar se "bisedimet me Kosovën duhet të vazhdojnë", por sipas tij, "nëse dikush mendon se me vënien e taksës do të zgjidhet problemi, e ka gabim". "Besoj se presioni ndaj Kosovës do të jetë gjithnjë e më i madh. Mendoj se të gjithë ua kemi borbx paqen brezave të rinj, sepse lufta nuk mund të na dërgojë askund", transmeton televizioni 'N1' të ketë thënë Aleksandar Vuçiç. Qeveria e Kosovës vendosi taksat 100% ndaj mallrave serbe në 21 nëntor të vitit të shkuar, pasi sipas autoriteteve në Prishtinë: "Serbia nuk po ndalet duke bërë agresion politik dhe diplomatik kundër Kosovës". Nga ana tjetër, taksat bëri që Serbia ta pezullojë dialogun me Kosovën. Dialogu Prishtinë-Beograd për përmirësimin e marrëdhënieve nisi shtatë vjet më parë, mirëpo rezultatet nuk ishin të kënaqshme. Bashkimi Evropian dhe SHBA-të tani po kërkojnë një marrëveshje finale, ligjërisht të obligueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në mënyrë që të dyja vendet, ndonëse në procese të ndara, të bëhen pjesë e BE-së.

të mbetet në fuqi derisa Serbia të ndryshojë qasjen ndaj Kosovës". "Ne nuk kemi urrejtje ndaj asnjë populli në botë mirëpo, do ta mbrojmë veten. Ose njihemi në mënyrë reciproke, ose siç kam thënë më herët, nëse Vuçiç e Daçiç thonë 'nikada' në gjuhën e tyre, 'nikada', pra 'kurrë nuk ju njohim', çfarë po presin atëherë prej nesh? Ne të themi po e largojmë tarifën? Jo, ata 'nikada'-ne kurrë, pra nuk e largojmë kurrë", tha Ramush Haradinaj pas një mbledhjeje të qeverisë. Kritike ndaj qëndrimit të kryeministrit Haradinaj u shpreh partia më e madhe opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Shefi i grupit parlamentar të kësaj partie Avdullah Hoti, tha se, "këmbëngulja e qeverisë për këtë tarifë është e pakuptimtë". "Sa më shumë që përkeqësohet situata në Kosovë duke u paralizuar institucionet e Ko-

Dje funerali i vogëlushit, tri ditë zi në Malaga të Spanjës

Qindra persona, në zi për 2-vjeçarin Julen, humbi jetën pasi ra në pusin 100 metra të thellë

Ditën e djeshme u për coll për në banesën e fundit i vogli Julen, djali dyvjeçar që ra në një pus rreth 100 metra në 13 janar. Trupi i tij i gjet pa jetë në natën mes të premtës dhe të shtunës. Qyteti spanjoll ka shpallur tri ditë zi. Arkëmorti me trupin e vogëlushit është transferuar dje në mbrëmje me varrezat e El Palo. Sipas të dhënave të autopsisë, Julen ka humbur jetën pikërisht ditën kur ka rënë në pus, shkruajnë mediat spanjolle. Miq e familjarë janë në zi për humbjen e 2-vjeçarit. Shërbimet e



emergjencës punuan pa pushim për të arritur 2-vjeçarin Julen Rosello, i cili ra në një pus të ngushtë dhe të jashtëligjshëm më 13 janar, gjatë kohës që prindërit e

tij përgatisnin drekën aty pranë. Ngjarja tragjike ndodhi në qytetin jugor të Totolan, pranë Malagas në Spanjë. Trupi i pajetë i të miturit u gjet të shtunën. Me qindra persona u mblodhën për të shprehur respektin e tyre. Dëshpërimi dhe dhimbja e madhe mund të shihej në fytyrat e prindërve të tij, Jose dhe Vicky Rosello, të dy 29 vjeç. Për 12 ditë, ata shpresuan së bashku me të gjithë Spanjën, që i mituri të ishte ende gjallë. Kjo është tragjedia e dytë në familjen

Rosello. Në maj të 2017-ës, ata humbën djalin tyre të parë Oliver, pasi pësoi sulm në zemër. Julen ishte vetëm 7 muajsh kur vëllai i tij vdiq papritur. Mediat spanjolle shkruajnë se Vicky e mbajti Oliverin në krahë për 3 orë pasi kishte vdekur në spitalin e fëmijëve. Prindërit, të cilët dikur ëndërronin të kishin një familje të madhe, mësohet se e vizitojnë varrin e tij çdo javë dhe flasin me të për orë të tëra. Ndërkohë, të dhënat e autopsisë mbi trupin e 2-vjeçarit Julen treguan e ai kishte pësuar dëmtime të shumta, të shkaktuara nga rënia në 100 metra thellësi.

Maduro i përgjigjet BE-së: Askush nuk mund të na japë ultimatum

Dezerton atasheu ushtarak i Venezuelës në SHBA

Liderët evropianë, ultimatum Maduros



NICOLAS MADURO

"Po sillen me arrogancë. Asnjë nuk mund të na japë ne ultimatum. Nëse duan të ikin nga Venezuela, le të ikin. Venezuela nuk është e lidhur me Europën. Kjo është arrogancë", - ka thënë Maduro në një intervistë për 'CNN' turk.

HOZE LUIS SILVA

"U bëj thirrje vëllezërve të Forcave të Armatosura të kombit të njohin Huan Guaidos si president legjitim", ka thënë kolonel Hoze Luis Silva, i cili zgjodhi t'i dilte kundër Maduros.

Presidenti venezuelian Nicolas Maduro hodhi poshtë ultimatumin e ditës së shtunë të BE-së që ka bërë thirrje për zgjedhje të reja, ose njohjen e presidentin të ri opozitar, Juan Guaido. "Po sillen me arrogancë. Asnjë nuk mund të na japë ne ultimatum. Nëse duan të ikin nga Venezuela, le të ikin", ka thënë Maduro në një intervistë për 'CNN'. "Venezuela nuk është e lidhur me Europën. Kjo është arrogancë, - ka ritheksuar ai. - Elitët evropiane nuk reflektojnë opinionin e popujve evropianë", thuhet në deklaratën e Maduros. Nga ana tjetër, kolonel Hoze Luis Silva, atasheu ushtarak venezuelian në Uashington është i pari ushtarak i lartë që braktis Presidentin Nikolas Maduro. Në një intervistë për mediat amerikane, Silva shprehu publikisht mbështetjen për presidentin e përkohshëm të vetëshpallur, Huan Guaido, i njohur nga Shtetet e Bashkuara, Gjermania e disa vende të tjera të botës, përfshirë edhe Shqipërinë. Duke e konsideruar Maduron si diktator, koloneli u bëri thirrje ushtarakëve në Venezuelë të ndjekin shembullin e tij. "U bëj thirrje vëllezërve të Forcave të Armatosura të kombit të njohin Huan Guaidos si president legjitim". Ministri venezuelian i Mbrojtjes shpalli publikisht besnikërinë e ushtrisë ndaj Nikolas Maduros, pas protestave të kësaj jave kundër presidentit majtist. Kreu i opozitës, Huan Guaido, u vetëshpall president i përkohshëm mes turmës masive të protestuesve në Karakas, duke e konsideruar të jashtëligjshme rizgjedhjen e Maduros president për një mandat të dytë, më herët gjatë këtij muaji. Presidenti amerikan Donald Trump nuk përjashtoi mundësinë e një ndërhyrjeje ushtarake në Venezuelë, nëse qeveria vijon të shtypë me dhunë protestat, gjatë të cilave janë vrarë më shumë se 20 persona. Gjermania, Franca, Britania e Madhe dhe Spanja kanë paralal-

jmëruar presidentin venezuelian Nicolas Maduro që të thërrasë zgjedhjet e parakohshme brenda 8 ditësh, në të kundërt do të njohin zyrtarisht kryetarin e opozitës si president të ligjshëm. Juan Guaido, kreu i opozitës, u vetëshpall President i Venezuelës dhe u betua si i tillë pas protestave masive të ditës së martë dhe të mërkurë. Guaido u njoh menjëherë nga Presidenti amerikan, Donald Trump si kreu i shtetit të Venezuelës. Po kështu veprori edhe Shqipëria pak orë më vonë, duke ndjekur rrugën e SHBA. Ndërsa ministri i Jashtëm i Venezuelës, Jorge Ar-

reaza u tha anëtarëve të Këshillit të Sigurimit në OKB se Presidenca e Nikolas Maduro është e ligjshme dhe refuzoi që ndërkombëtarët të japin ultimatum nëse duhet të ketë zgjedhje të parakohshme ose jo në Venezuelë. Maduro ka akuzuar Guaido për organizim të grushtit të shtetit, ndërsa diplomatët amerikanë i ka urdhëruar të largohen nga vendi. Venezuela rrezikon një luftë civile, ndërsa edhe ndërkombëtarët janë ndarë se cilin mbështesin si President të vendit. Në krah të Maduros janë rreshtuar Rusia, Kina, Meksika dhe Turqia.

DITA E PËRKUJIMIT TË HOLOKAUSTIT



FOTOLAJM

Dje në mbarë botën ishte Dita e Përkujtimit të Holokaustit. Në vitin 2005 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi një rezolutë që shpallte 27 janarin si Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit në nderim të viktimave të Holokaustit. Kjo ditë përkujton miliona viktime të politikave të gjenocidit të Gjermanisë naziste që u kryen gjatë Luftës së Dytë Botërore.

SHKURT

Angli, gjyshja rekordmene ngjitet në mur në moshën 99-vjeçare

Greta Plowman, një e moshuar 99-vjeçare, që jeton në Hatfield, në Angli, ka arritur me sukses, pavarësisht moshës, të ngjitet në një mur rreth 6 metra, duke u bërë kështu gruaja më e moshuar që ka realizuar një ngjitje të tillë. Në dhjetor Greta, u ngjit në këtë mur vetëm për të shoqëruar vajzën e saj Judith, 70 vjeç, por pasi pa performacën e saj, vendosi të futet në lojë, e mbështetur edhe nga nipi, Tim Dobson, duke ngjitur këtë mur, për herë të parë në jetën e saj. Ka qenë vetë Tim që ka filmuar gjithçka dhe e ka publikuar në rrjetet sociale, duke dokumentuar kështu një rekord botëror Gines.

Shpërthime në kishë, humbin jetën 27 persona në Filipine

27 persona humbën jetën e dhjetëra të tjerë u plagosën nga shpërthimi i dy bombave në një kishë në Filipine. Shpërthimet ndodhën në ishullin jugor Xholo. Autoritetet dyshojnë se pra-pa sulmeve fshihen grupet ekstremiste islamike. Tensionet politike në këtë zonë janë të larta, pasi javën e kaluar shumica e banorëve myslimanë mbështeti referendumin për më tepër autonomi nga autoritetet në Manila.

Paris, vidthe murali i Banksy në Bataklan

Një mural ku shfaqej një grua në zi, që i atribuohet Banksy dhe që ishte vendosur në një portë të Bataklan, në kujtim të 90 viktimave të atentatit terrorist në teatrin e Parisit në nëntor të 2015, është vjedhur, ka bërë me dije teatri në një njoftim në "Twitter". Murali u shfaq në qershorin e kaluar mbi një derë të teatrit. Sipas policisë, hajdutët kanë vjedhur të premtën natën, duke hequr plotësisht portën. Teatri ka komentuar me një "tweet", që "vetë ekzistenca e artit urban është për t'i dhënë jetë një veprë arti, pikërisht në një ambient të veçantë dhe ne jemi të bindur që ajo veprë ka kuptim vetëm në këtë vend të rëndësishëm. Kjo është arsyeja përse ne e kemi lënë aty, të lirë, në rrugë, për t'u parë nga të gjithë".

Opinion i Ditës

Kthesat e papritura të lëvizjes studentore

Nga Agred Tafaj

(villon nga faqja 1)

...Megjithatë, nuk e dinim se si do ta kurorëzonim atë që ndjenim. Rregullat fillestare bazë për të cilat dakordësuar pa debat ishin "Jo politikë, jo negociata, jo përfaqësi". Kjo marrëveshje pa debat na solli deri në fund të dhjetorit, para daljes së Paktit qeveritar për Universitetin. Por ngjarjet rrodhën ndryshe nga çfarë ne prisnim. Grupi i studentëve virtualë nuk llogariti pasojat e kurrthit të Paktit për universitetin. Një masë studentësh dhe prindërit e tyre, përballë frikës së përballimit me presionin qeveritar, u mjaftuan me disa kothere buke të thatë që lëshoi pakti. Pjesa tjetër e studentëve të velur nga politika, alergjia për krahët e saj (pozitë/opozitë), por njëkohësisht të ndodhur nën presionin e pasojave të pushtetit, zgjodhën pozicionin e pritjes së çfarë do të ndodhë. Ndërkohë që grupi i studentëve pararoje të vendosur në kauzën e tyre, u ngjuan në fakultete.

Megjithëse e vonuar, asambleja e pedagogëve të Universitetit të Tiranës ka sjellë një kthesë të papritur në lëvizjen tonë studentore. Tashmë ne, studentët, gjatë këtyre muajve dy muajve, kemi pësuar një metamorfozë që jashtë këtyre ngjarjeve do të na duheshin vite. Tashmë kuptojmë se mbështetja e pedagogëve është thelbësore, jo vetëm në identifikimin e problemeve reale të arsimit të lartë, por edhe të vetë shoqërisë dhe politikëbërjes në Shqipëri. Rrëzimi i ligjit të arsimit të lartë është një leksion demokracie për vendim-marrjen e vetë qytetarëve për liri dhe të drejtat e tyre. Imagjinoni kur kjo e drejtë u mohohet akademikëve, profesorëve që nuk janë vetëm mentorët tanë, por edhe të gjithë shoqërisë, çfarë duhet të



mendojmë ne për të drejtat e bujqve, punëtorëve, të gjithë llojeve të protestuesve, përfshirë dhe ata të Unazës së Re? Imagjinoni kur e drejta për të vendosur për veten e vet i mohohet studentit, që ka të gjitha potencialet dhe en-

ergjitë për të reaguuar në mënyrë të papërmbytshme, çfarë mund të ndodhë me shtresat e tjera të shoqërisë?

E gjithë kjo revoltë për cenimin e dinjitetit u adresohet forcave politike që kanë pasur pushtetin si

mjet sundimi. Megjithatë, alergjia për klasën politike, edhe pse adresimin e ka të këto dy forca, është tej kufijve të saj realë, duke përfshirë edhe forca politike apo individë të shquar, që nuk kanë pasur kurrë pushtet. Tashmë ne

studentët, me kthesën që po merr lëvizja jonë, jemi shpresëplotë që do të vendosim në lëvizje të gjithë shoqërinë, duke vënë nën presion forcat pushtetmbajtëse pozitë-opozitë, që të heqin dorë nga sundimi mbi individin, t'i japin mundësinë atij të zgjedhë e zgjidhet lirish, që të nënshkruajë kontrata elektorale të ndershme, të mos bëjnë sikur luftojnë kundër njëri-tjetrit dhe në fund, të mos bëjnë rotacione politike me kompromise që mbajnë erë.

Prandaj ne, studentët e ngjuar po ndërgegjësohemi dita-ditës se jemi vetëm në hapet e para të lëvizjes sonë studentore, e cila ka marrë bekimin nga pjesëmarrja e dhjetëra e mijëra studentëve në disa javë. Në ditët e para të dhjetorit ishim shumë larg me atë që mendojmë sot, por jemi të bindur se ende jemi larg asaj që do të duhet të arrijmë. Profesorët tanë do dinë të na korrigjojnë në detyrat tona të shtëpisë. Prandaj kemi besim të patundur në cilësinë e mendimit intelektual, në ndershmërinë dhe përgjegjshmërinë e tyre për interesa kombëtare dhe në guximin e tyre për t'u përballuar me agresionin e pushtetit. Jo vetëm profesorët, por edhe ne jemi të qartë se politika është e armatosur me armë speciale për të eliminuar çdokënd që përbën rrezik për të nëpërmjet makinerisë së baltës, që është përpjekur të bëjë pis çdo pedagog. Historia na ka mësuar se çdo kombi kur i është dashur të tregojë veten, të bëjë kapërcime të rëndësishme në momente të vështira me veprime të sforcuara, nuk i kanë munguar vajzat dhe djemtë kurajozë dhe as gratë e burrat e urtë e të mënçur, të gatshëm për sakrificë. Prandaj ne, studentët e ngjuar dhe pedagogët e Universitetit të Tiranës do të jemi në pararojë të ndryshimeve që koha i kërkon shoqërisë shqiptare.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NË
MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



Opinioni *i* Ditës

Letra e 30 shkrimtarëve europianë, si shuplakë për copëtuesit e Kosovës

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... të interpretohet nga një mori këndvështrimesh të ndryshme.

Ajo mund të përndezë gjakrat e një europiani të djathtë, që nuk e gjen fajin e vetëm për këtë që po ndodh te rritja e ekstremizmit, te demagogët dhe populistët që etiketohen si fajtorët ekskluzivë të situatës aktuale, por që i shpjegojnë ato me kalimin e sovranitetit të burokratit e pavotuar të Brukselit, me anashkalimin e qytetarëve të thjeshtë të vendit të tij dhe me zhberjen e identitetit kombëtar, në emër të elitave kozmopolite të shkëputura krejtësisht nga realiteti.

Ajo mund të shihet me përcimim nga një besimtar i së majtës, pasi u bishtnon problemeve reale të krizës së sotme: akumulimin e pushtetit në duart e pakicës, rritjen galopante të pabarazive, qeverisjet e vëna në funksion të bankave dhe korporatave, këmbënguljen në politikat çnjerëzore të frymëzuara nga teoritë neoliberalë, të cilat sollën rendjen e më të pambrojturve drejt ekstremeve dhe zhgënjimin nga ëndrra fillestare e Europës.

Por, pavarësisht nga polemikat, nëse ky apel është në gjendje të rrokë ose jo thelbin e krizës së sotme, ai mbart një mesazh disi të ndryshëm, por tejet të fortë për mbarë botën shqiptare.

Sepe në këtë moment, kur në të dyja anët e mëdha të kombit tonë po gëlon debati i dialogut shqiptaro-serb, kur më shumë se kurrë, si zgjidhje e artë po serviret rivizitimi i kufijve etnikë, kur si opsion final për fundin e të tëra problemeve po shitet bashkimi kombëtar, kur ideja e tij po përdoret si një shantazh nacionalist ndaj kontinentit të vjetër që refuzon të na pranohet në gjirin e vet, thirrja e 30 shkrimtarëve europianë jep dy mesazhe të forta.

I pari konsiston në faktin se "atdheu i dytë për të gjithë njerëz-



it e lirë të globit" është braktisur nga Amerika e Trump-it dhe rrezikohet nga Rusia e Putinit.

Mesazhi i dytë, edhe më i fortë, është se zgjidhja nuk gjendet te thirrjet e demagogëve populistë për t'u kthyer te shpirti i kombeve, te përkatësitë etnike, te ngritja e mureve dhe te fshehja pas kufijve nacionalë.

Por, kohët e fundit të gjithë ata që po propagandojnë copëtimin e Kosovës dhe gjetjen e zgjidhjes së artë përmes shkëmbimit të territoreve, që krijojnë shtete etnikisht të pastra, po i mbështesin pikërisht këtu themelet e projek-

tit të tyre të ardhshëm.

Ajo që thonë nën zë është se plani i tyre ka nga pas miratimin e Trump-it dhe Putinit. Ajo që e shprehin me gojë plot është se krijimi shteteve etnikisht të pastra mbetet shkopi magjik që do të zgjidhë të gjitha problemet.

Në këtë kuptim, letra e 30 shkrimtarëve të shquar europianë, edhe nëse s'bie ideologjikisht dakord me optikën e tyre, është një porosi e madhe për mbarë shqiptarët.

Sepe ajo përbën një apel për të parë drejt vlerave të përbashkëta të së ardhmes dhe jo për t'u

ngujuar te zgjidhjet e provuara nacionaliste të së shkuarës, sepe ajo e sheh zgjidhjen të triumfi i një identiteti të përbashkët europian dhe jo te kthimi në "shpirtin e kombit" që propagandojnë demagogët populistë.

Pikërisht për këtë, ajo mund të lexohet si një shuplakë e fortë kundër të gjithë atyre që duan t'u imponojnë shqiptarëve (po aq sa edhe serbëve) zgjidhje që bien kryekëput ndesh me idealin e një Europe që kërkojmë dëshpërimisht të përqafojmë.

"Lapsi.al"



HOROSKOPI

DASHI

Nuk këshillohet që sot të pushoni apo vetëm të relaksoheni. Shumë aspekte të jetës do të kërkojnë një drejtim. Nëse ju dëshironi, mund të realizoni shumë gjëra. Mund të konfliktoheni me një person shumë të afërt.

DEMI

Kjo e hënë do t'ju vëri përballë disa detyrave të vështira. Mund të jetë diçka që nuk mund ta zgjidhni brenda 24 orëve. Ata që janë të përfshirë në biznes, nuk duhet të ndërmarrin vendime të nxituara. Sa i përket jetës personale, nuk do të jetë dita e duhur.

BINJAKET

Disa binjakë do të duhet të punojnë shumë. Një prej kolegëve mund të sëmurët dhe për këtë arsye do të duhet të pëmbushni edhe disa prej përgjegjësiave të tij/saj. Në familje do të përballeni me disa probleme, por që do të zgjidhen më shpejt seç mund ta kishit besuar.

GAFORJA

Përpiquni të jeni sa më të qetë gjatë ditës së sotme. Punoni pa u nxituar. Pjesa tjetër e ditës do të shkojë për më së mirë. Sa i përket jetës në çift, do të kaloni një mbrëmje ashtu sikurse e dëshironi.

LUANI

Disa persona të kësaj shenje do të bëhen arrogantë sot. Dëshira për të marrë komplimente dhe për t'u vlerësuar do të rritet. Megjithatë, përpiquni të mos udhëhiqeni nga kjo sjellje. Sa u përket financave, profesioni dhe dashurisë do të jenë në gjendje të qëndrueshme.

VIRGJERESHA

Të lindurit e kësaj shenje nuk rekomandohen të nisin projekte të reja këtë të hënë, pasi ka gjasa që iniciativa të tilla të përballen me skepticizëm. Do të keni fat, nëse punoni vetëm. Sot do të keni dëshirë të përmirësoni ndjenjat tuaja.

PESHORJA

Peshoret mund të kenë edhe sjellje ekstreme gjatë ditës së sotme. Mund të doni të nisin një çështje profesionale me shpejtësi, por më pas nuk do e keni më këtë dëshirë. Kjo tregon se sa të luanur do të jeni gjatë ditës së sotme. Përpiquni të mbanin veten nën kontroll dhe silluni me seriozitet sa më shpejt të jetë e mundur.

AKREPI

Akrepat duhet të analizojnë njerëzit e afërt. Rekomandohet që të largoni ata persona që tërhiqen lehtë, nuk kanë besim tek ju, apo që duan të përfitojnë prej jush. Dita e sotme nuk këshillohet për të kërkuar punë të re apo për ndonjë marrëveshje biznesi.

SHIGJETARI

Sot do të udhëhiqeni nga pozitiviteti. Nuk do të keni asnjë arsye për t'u shqetësuar, gjatë do të thotë se mund të relaksoheni dhe të mendoheni për të ardhmen. Megjithatë, mbanini nën kontroll punën, dashurinë dhe financat.

BRICJAPI

28 janari do të sjellë kënaqësi për Bricjapët. Puna juaj do të vlerësohet. Disa prej jush do të gjejnë një burim të ri të ardhurash, ndërsa disa do të gjejnë dashurinë e tyre në jetë.

UJORI

Ujorët nuk duhet të tërhiqen sot nga asgjë. Guximi juaj do të rezultojë me sukses. Në mbrëmje do të befasoni nga një surprizë shumë e këndshme. Mund të bëheni pjesë e një eventit kulturor.

PESHQIT

Peshqit mund të ndihen të pakënaqur. Kjo mund të vijë për shkak të shëndetit tuaj, pasi nuk do të ndiheni mirë. Bëni mirë të shkoni te mjeku dhe të mos neglizhoni. Megjithatë, në mbrëmje gjendja juaj do të përmirësohet, teksa do të jeni nën shoqërinë e gjysmës së zemrës tuaj.



Në Gjirokastër mbyllet 1-5

Kastrioti i shkakton humbjen më të thellë në histori Luftëtarit

Kastrioti doli me një fitore të thellë nga Java e 19-të në Kategorinë Superiore, teksa mundi brenda në Gjirokastër Luftëtarin me shifrat 1-5. Shumë shpejt. Shifrat u zhblokuan nga Xhuniur që në minutën e 10-

të, ku pas një pasigurie të portierit Ruçi, me portën e boshatisur braziliani shënoi. Në fundin e pjesës së parë, krutanët dyfishuan me penalltinë e Markut, e cila u fitua pas një bërrii të kapitenit Rapa. Me nisjen e

pjesës së dytë, bluzinjët u hodhën për të kërkuar barazimin dhe e gjetën me Filipin me kokë, në minutën e 70-të. Por, teksa pritej sërish reagim nga ekipi i Mezanit, krutanët nga ana tjetër shënuan tri herë të tjera në

momentet e fundit të sfidës, duke i kapur në kundërsulme. Marku në të 83-tën, Rami 3 minuta më vonë dhe Taulant Marku në minutën e 90-të çuan shifrat në 1-5, duke i sjellë kështu edhe humbjen më të thellë ndonjëherë brenda në Gjirokastër ekipit të Luftëtarit. Me këtë fitore, Kastrioti mbetet në vendin e fundit, me 13 pikë, ndërsa Luftëtari në vendin e tetë me 17 pikë.



Jeton Selimi

Batha do të befasojë durrsakët, Traore do të barazojë për Teutën. Velu del me të kuq, Bushiçit i anulohet gol

Tirana e kthen në festë me Kamzën, Flamurtari ndal Teutën e Bushiçin

Kryeqytetasit shpërthejnë në pjesën e dytë, fitojnë 4-1

Tirana vijon rrugën e fitoreve të nisura që në përballjen e Kupës së Shqipërisë ndaj Flamurtarit, teksa ka fituar derbin ndaj Kamzës me rezultatin 4-1. Një fitore e vuajtur, por që ka gëzuar të gjithë tifozërinë bardheblu. Në fakt, Tirana e nisi ndeshjen shumë keq, pasi Kamza u tregua mjaft racionale dhe me anë të Sebino Plakut që në minutën e 3-1 mposhti portierin Abibi. Momenti kulmor i këtij fraksioni do të vinte në minutën e 42-të, kur bardheblutë do të fitojnë një penalti me anë të Edon Hasanit, teksa Kamza mbetet me 10 lojtarë, pasi Oriand Beqiri ndëshkohet me karton të kuq. Por gardiani kamzali, Avdyli, do të presë 11-metërshin e goditur nga Ngo dhe ekipet do të shkojnë në pushim me fitoren e Kamzës. Por në pjesën e dytë, Tirana do të shpërthejë me një poker golash. Hasani do të rikthejë baraspeshën në të 59-tën pas asistit të Ngo. Shkodrani shkon në festojë me tifozët e tij, por këta të fundit e përzënë, ndërsa më pas godasin me ç'të mundën kapitenin Karabeci gjatë ekzekutimit të goditjes së këndit. Por Ngo nga personazhi negativ, kthehet në heroin e mbrëmjes, kur në të 67-tën i kalon bardheblutë në epërsi, ndërsa 7 minuta më pas asiston mjaft mirë Hasanin, që realizon golin e tretë të



ndeshjes dhe të dytin personal. Për t'i vënë kapak takimit mendoi Albi Doka, që shërbehet mjaft mirë nga Hoxhallari

dhe realizon pokerin e Tiranës. Bardheblutë ngjiten në kuotën e 20 pikëve dhe shkëputen me 5 pikë nga Kamza e

SUPERLIGA	
JAVA E 13-të	
TE PREMTEM	Skënderbeu - Partizani 0-1
TE SHUTUNEN	Kukësi - Laçi 0-0
TE SHUTUNEN	Luftëtari - Kastrioti 1-5
	Teuta - Flamurtari 1-1
	Tirana - Kamza 4-1

vendit të parafundit. Dueli i dy skuadrave bregdetare në "Niko Dovana" nuk ka nxjerrë asnjë fitues, teksa Teuta dhe Flamurtari janë ndarë në barazim 1-1 në përfundim të një 90-minutëshi mjaft të luftuar. Të parët që kanë kaluar në epërsi kanë qenë miqtë, që kanë befasuar të zotët e shpësisë në minutën e 13-të. Idriz Batha do të ekzekutojë saktësisht penalltinë e fituar nga Agustin Torasa në dyluftim me Ditmar Bicajn. Megjith-

atë, epërsia kuqezi nuk do të zgjasë shumë, sepse në minutën e 27-të Teuta do të barazojë. Traore shfrytëzon maskimalisht një top të ardhur nga e majta dhe daljen e gabuar të Koliçit, duke sigëruar rezultatin 1-1. Pjesa e parë do të mbyllet me këtë rezultat, ndërsa emocionet nuk do të mungojnë as në pjesën e dytë. Franc Velu del me 10 lojtarë të tijtë në minutën e 59-të, pas ndërhyrjes ndaj Bushiçit, Kroati që debutonte me Teutën pikërisht ndaj ish-skuadrës së tij do të shënojë në të 66-tën, por goli i tij do të anulohet pas një pozicioni jashtë loje të simjliuar nga vijërojtësi. Teuta, në superioritetin numerik, hidhet e gjitha në sulm, por deri në fund rezultati nuk do të ndryshojë dhe durrsakët do të humbasin rastin për t'i marrë Kukësit vendin e dytë. Nga ana tjetër, Flamurtari shkon në 29 pikë, 9 më shumë sesa Tirana vendit të shtatë.



Barça nuk ndalet, ndaj Gironës vjen fitorja e tetë radhazi

Barcelona nuk gabon as në derbin e Katalunjes ndaj Gironas. Skuadra e Ernesto Valverdes triumfoi 0-2, duke e çuar sërish në +5 pikë avantazhin ndaj ndjekësës më të afërt në La Liga, që është Atletico e Madridit. Në transfertën e Gironas vendosën golat e Semedos dhe Mesit me Barçën që regjistroi fitoren e 8-të radhazi në La Liga, duke hedhur një tjetër hap të sigurt drejt mbrojtjes së titullit. Vendësit e mbyllën sfidën me një lojtar më pak, pasi në minutën e 51-të Espinosa mori kartonin e dytë të verdhë.

NDËRLIKOHET TRANSFERIMI

Pak ditë më parë, Çelsi firmosi me sulmuesin argjentinas Gonzalo Higuain, duke i lënë rrugën e hapur një largimi të mundshëm të Alvaro Moratës. Për këtë të fundit kishte shumë skuadra që interesoheshin, por Atletiko Madridi arriti të bënte ofertën më të lartë, duke bindur edhe drejtuesit e klubit londinez. Por, mesa duket ka probleme për transferimin e Moratës tek Atletiko, duke qenë se tifozët e kësaj skuadre janë kundër transferimit të tij. Në të kaluarën, Morata ka qenë pjesë e Real Madridit, që është njëkohësisht edhe rivali i qytetit për Atletikon. Rivali-

Tifozët e Atletikos shpërthejnë kundër Moratës



teti që skuadrat kanë me njëra-tjetrën ka bërë që tifozët të jenë kundër një lëvizjeje të tillë. Në ndeshjen e fundit që Atletiko kishte në kampionat, tifozët kanë shpërthyer në kore ndaj Moratës, duke kërkuar që të mos realizohet

ky operacion, madje ata ishin dakord që të promovohet një talent nga akademja. Tashmë mbetet të shihet se çfarë do të bëjnë drejtuesit e Atletikos, por i sigurt është fakti se Morata do ta ketë të vështirë ambientimin në Madrid.

PASDITE E 'TMERRSHME'


22 gola në 4 ndeshje, e diela e Serie A dhuron spektakël dhe emocione pafund. Pas breshërisë së golave që prodhoi sfida mes Kievos dhe Fiorentinës, spektakli vazhdoi edhe në sfidat e orës 15:00 me dy përmbysje të çmendura. Atalanta arriti t'i merrte një pikë Romës, duke rikupëruar disavantazhin e tre golave. Me Berishën dhe Gjimshinin në fushë që nga minuta e parë, bergamaskët e panë veten në disavantazhin e tre golave në harkun e 40 minutave, kur Roma realizoi tri herë me Dzekon, i cili shënoi një dygolësh dhe El Sharauin. Megjithatë, Atalanta rindezi shpresat

"Çmendet" Serie A, 22 gola në vetëm 4 ndeshje

për të bërë diçka në sekondat e fundit të pjesës së parë me Kastanjen. Iliç humbi një mundësi të shkëlqyer, por nuk vonoi shumë dhe Atalanta rihapi sfidën me qendërmbrojtësin Toloi. Për të barazuar shifrat mendoj golashënuesi më i mirë i skuadrës, sulmuesi kolumbian Duvan Zapata, i cili në pak sekonda u kthye nga djall në engjëll. Në të 70-tën, bombieri i Atalantës humbi një 11-metërsh të akorduar nga sistemi VAR për një faull ndaj Iliçit, ndërkohë që pak sekonda më vonë barazoi shifrat. Atalanta u përpoq deri në fund të merrte fitoren,

por nuk ia doli dot, duke humbur disa mundësi të mira. Kjo pikë nuk kënaqi asnjërin prej dy skuadrave për mënyrën sesi rrodhi ndeshja. Në sfidat e tjera Frozinone mori një fitore të thellë me shifrat 0-4 në fushën e Bolonjas, duke vulosur edhe shkarkimin e Filippo Inzagit nga stoli i kuqebluve dhe duke ringjallur njëkohësisht shpresat e saj për mbijetesë. Ndërkohë, Spal përmbysi Parmën, që kishte realizuar dy herë me Inglesen duke marrë një fitore të rëndësishme, që e largoi akoma më shumë nga fundi i renditjes.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Riza aktor.
- Një fjalë si hiç.
- Një mund të jetë diplomatik.
- Premtom të bëhet as.
- Janë felinë... të zinj.
- Ami i Maupassant.
- Heroi i Emilio Salgarit.
- Qe anarkist i famshëm rus
- Një mungesë gjaku.
- Susanna shkrimtare
- Të parat në cilësi.
- Mbyllin një shtëpi.
- Mbeten në fund.
- Qendër në kaos.
- Ka bërë piktoreskë një i tillë
- Inicialet e Camus.
- Motra... e Kolë Idromenos
- Një konfuzion total.
- Rastet pa set.
- Rastisin në krye.

- Fillojnë detyrën.
- Bektashi këngëtare.
- Andrea aktore.
- Sampras i tenisit.
- Shkroi Korbi (indic).
- Triolet e Trëndafilë me kredi.
- Kilmer aktor.
- Në krye të robotëve.
- Unë dhe ti.
- Një mund të jetë fetar.
- Stephane poet francez

VERTIKAL

- Fillojnë praktikën.
- Britma e Arkimedit.
- Ekstreme në trap.
- Në fund të fundit.
- Janë fjetoret e ushtarëve
- Parker regjisor.
- Vivaldi kompozitor.
- Një shkop për karambol.
- Janë firmat rentiere.
- Një i fundit mbi të gjithë
- Kufizojnë tatimet
- Janë nomadë.
- Panik pa kufij.
- Fryn detin
- Sidney regjisor i Serpico.
- Jep alarmin.
- Fillojnë nazet.
- Janë illogarit.
- Roman regjisor.
- Alan regjisor.
- Roman regjisor.
- Eshtë X ajo e sulmit.
- Kapen të parat.
- Një provë... inteligjencë.
- Një markë lap top.
- Fillojnë matjet.
- Rruga e Ferenc Molnar.
- Qerre pa qe.
- Fillojnë lirinë.
- Fillojnë vallen.
- Në mes të dhomës.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Një doktor... i Fritz Lang
- U paraprind hoteleve.
- Kush nuk ka... nuk ha
- Eshtë djall
- Një mund të ketë i rralle.
- Ishin perëndi të Samotrakias.
- Institucione Botuese Autonome.
- Eshtë infeksion në bark
- Fundi i një samurai.
- Një markë kafeje.
- Mbyllin një hark.
- Mund të jetë emërore.
- Ishte muzikanti që nuk përsërite.
- Në krye të avokatëve.
- Qerre pa qe.
- Një pjesë e adoleshentëve.
- Një banor imagjinar i planetit të kuq.
- Nuk shuhej dot nga Tantali.

VERTIKAL


- James, armiku i Sherlock Holmes.
- Eshtë edhe ajo saudite.
- Imami aktore
- I kanë çift turket.
- Inicialet e Seagal aktor.
- Eshtë dëshmore... çudibërëse.
- Në fund të lutjes.
- Eshtë sporti me stil të lirë.
- Mbeten në fund.
- Eshtë rasti i veçantë, karakteristik.
- Conan ai i Schwarzenegger.
- Gjysmë ditari.
- Mario, që qe bomber argjentinas.
- Mund të prishej nga një... kleçkë.
- Në hyrje të pistës.
- Një numër... femrash.
- Eshtë qyteti i Besës
- Qyteti që quhej edhe Sebaste.
- Njëlljo për latinët.
- Mund të bëjnë stil të lirë.
- Damon aktor.
- Eshtë pije e jona.
- Në krye të noterëve.
- Film i Robert Altman.
- Skuadra merengue.
- Një pjesë e hasmërisë.
- Rralle është përgjysmë.
- Nisur pa kufij.
- Fillojnë mobilizimin.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



SUDOK

9		3							
	5	1	3		4				2
2		7			8			6	
5	9				2	6			3
							8	5	
					9				
1							1	4	
2		8	4		7				6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	2	7	9	1	8	3	6	5	
1	3	5	2	6	7	9	8	4	
6	8	9	4	3	5	1	7	2	
9	7	2	5	8	4	6	1	3	
8	4	6	3	2	1	5	9	7	
5	1	3	7	9	6	2	4	8	
3	9	1	8	7	2	4	5	6	
7	6	4	1	5	3	8	2	9	
2	5	8	6	4	9	7	3	1	

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

6	2	9	13	15	11	7	2		1	11	2	7	
4	9	12	4	11		2		14	13	15	8	2	
	1		12	4	2	12	4	11		6	1	8	
4	11	2			5	10	3	1	15		12	2	
7	4	12			5	10	3	4	6	1	7	2	12
3					5	10	3	1	14	4	6	1	
4	12	2			5	1	7	2	12		11	4	3
7	10	6	10		14	4	8		12	10	7	4	
12	11	1			9	4			12	6	8	15	8
1	12				12	15	12	15		1	12	1	14
7	2	14	4	12		7	K ¹⁰	O ⁹	S ¹²	H ³	3	4	
4	12	1	7		9	4	7	9	4	11	4	12	

K	U	L	T	M	A	P	L	A	B				
O	R	E		K	A	S	T	I	L	E	R		
R	U	L		A	K	T	O	R	I	A	L	E	
B				K	L	E	O	P	A	T	R	A	
I	E	K		I	T	R	E	T	E			S	
L	A	M	E	K	E	R	M	A	T				
T	E	R	M	A	T	A	R	I	C	E			
O	T	O	S	C	I	R	M	A					
B	R	E	D	H	I	A	I	R	K				
I	L	E	I	N	E	P	H	I	L				
A	N	A	L	I	T	I	K	E	A	M	I		
S	E	T	E	S	K	I	C	A	T	O			



- Vdekja nuk duhet të kihet frikë nga të mënçurit .
- Vetëm virtyti garanton një Karma të mirë dhe virtyti më i lartë është dhembshuria.
- Në të vërtetë kurrë , këtu poshtë (Bota materiale) , nuk mund të shuhet urrejtjet me urrejtje .
- Me të njëjtën thjeshtësi që era çrënjës një pemë të brishtë , tundimet tërheqin atë që është në kërkim të kënaqësive , që është i pangopur (lakmitar) , dembel dhe idobët . Por , si era që nuk mund të lëkundë një mal , asnjë tundim nuk lëkund të urtin , energjikun , të besueshmin që jeton thjeshtë .



- Në këtë botë të gjithë do vdesim . Kujto , si mund të mbash armiqtësi ?
- Në këtë botë urrejtja nuk mund t'i japi fund urrejtjes . Vetëm dashuria është e aftë ta shuajë atë . Ky është Ligji i Përgjithshëm .

- Jemi ajo që mendojmë . Ajo që jemi është produkt i mendjes sonë . Çdo fjalë ose vepër që lind nga ndonjë mendim i turbullt , ndiqet nga vuajtje , ashtu si rrota e karrocës që ndjek këmbët e demit .

